

1 E enjte, 28 tetor 2021

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuarit hyjnë në sallën

4 e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 09.30

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

7 Mirëmëngjes dhe mirë se erdhët të gjithë.

8 Znj. Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Lënda

10 KSC-BS-2020-07, Prokurori i Specializuar kundër Hysni Gucatit

11 dhe Nasim Haradinajt.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] A ka

13 ndonjë ndryshim në përbërjen e ekipit të Prokurorisë?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] I vetmi dallim është që

15 stazhierja Molly Norburg, nuk është sot e pranishme.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Në

17 rregull.

18 Te ju z. Rees dhe z. Cadman?

19 Z. REES: [Përkthim] Jo, as te ne nuk ka ndryshime.

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, as tek ne nuk ka ndryshime.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Theksoj se

22 të pranishëm në sallë janë dhe z. Gucati dhe z. Haradinaj.

23 Sikurse u tha dje, sot do të marrim vendim në lidhje me

24 vendimin, kërkesën e përbashkët të Mbrojtjes sipas rregullit

25 102(3) para fillimit të dëshmisë së dëshmitarit 4842.

1 Trupi Gjykses rikujton se dje hodhi poshtë kërkesën e
2 Mbrojtjes së Gucatit në lidhje me informacionin e ri që do të
3 japë Dëshmitari 4842 dhe theksoi se informacioni shtesë ishte
4 i kufizuar për nga natyra dhe fushëveprimi; dhe se dëshmia e
5 pritur e dëshmitarit nuk do të dalë jashtë asaj për të cilën
6 është njoftuar Mbrojtja.

7 Paneli tani ka marrë një kërkesë të re të përbashkët të
8 Mbrojtjes së Gucatit dhe të Haradinajt. Ne do ta thërrasim atë
9 kërkesën në lidhje me nxjerrjen e materialit.

10 Në këtë kërkesë Mbrojtja kërkon nxjerrjen sipas rregullit
11 102(3) të informacionit që sipas Mbrojtjes është thelbësor për
12 përgatitjen e pyetjeve për Dëshmitarin 4842. Mbrojtja
13 parashton se kjo nxjerrje materialesh është e domosdoshme si
14 pasojë e informacionit të ri që ka nxjerrë dëshmitari.

15 ZPS-ja nga ana tjetër thotë se kërkesa e Mbrojtjes për
16 nxjerrje materialesh është e vonshme dhe shumë e gjerë. Ajo
17 thekson se procedura e përgatitjes së Dëshmitarit sikurse
18 përcaktohet në vendimin e Gjykatës bëhet e papërdorshme.

19 Përpara se të marrë vendim, Trupi Gjykses rikujton se
20 Gjykatësi i Procedurës Paraprake ka theksuar se: Mbrojtja (i)
21 mund të kërkojë nxjerrjen ose inspektimin e materialeve që nuk
22 janë të përfshira në njoftimin sipas rregullit 102(3); në një
23 rast të tillë, Mbrojtja duhet të përcaktojë parametrat dhe të
24 specifikojë dokumentet e kërkuara; (ii) të indikojë tërësinë e
25 materialeve që i duhen për përgatitje.

1 Për sa i përket parametrave të specifikimit, Gjykatësi i
2 Procedurës Paraprake ka theksuar se: Këtu mund të përfshijnë
3 një grup i caktuar dëshmitarësh; një periudhë kohore dhe vend
4 gjeografik ku ka ndodhur ngjarjet materiale; një kategori
5 dokumentesh që përcaktohen për nga kriteri i cili është i
6 zbatueshëm lidhur me një grup individësh.

7 Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjithashtu ka theksuar
8 se Mbrojtja nuk mund të mbështetet në përshkrime të
9 përgjithshme apo pretendime të përgjithshme në lidhje me
10 informacionin e kërkuar dhe duhet t'i shmanget kërkesave në
11 formë të përgjithësimeve.

12 Ky vendim është për procesverbal, i shënuar me numrin
13 F172, paragrafi 26.

14 Trupi Gjykues thekson se kërkesa e Mbrojtjes për nxjerrje
15 materialesh përfshin, pothuajse, të gjitha shënimet që ka bërë
16 ZPS-ja në lidhje me mbrojtjen e dëshmitarëve, duke përfshirë
17 edhe masat që janë marrë në terren. Gjithashtu përfshin edhe
18 shënimet nga takimet e brendshme në lidhje me kontaktimet e
19 dëshmitarëve dhe vendimet udhëheqësve në lidhje me ato që nga
20 tetori i vitit 2020.

21 Edhe pse sistemi i nxjerrjes së materialeve ka mundësuar
22 një mënyrë efektive që Mbrojtja të marri informacion relevant,
23 ai nuk duhet të përdoret si mënyrë për përshpejtim.

24 Trupi Gjykues, gjithashtu, nuk është bindur se Mbrojtja
25 ka treguar apo dëshmuar materialitetin në lidhje me nxjerrjen

1 e këtyre materialeve për sa i përket dëshmisë së dëshmitarit
2 4842. Në qoftë se gjatë pyetjeve kryesore për dëshmitarin,
3 dëshmitari pyetjet për të dëshmuar në lidhje me çështjet që
4 dalin jashtë fushë veprimit të deklaratës së tij dhe njoftimit
5 të datës 14 tetor, atëherë këto çështje bien nën fushëveprimin
6 e kërkesës së Mbrojtjes për nxjerrje materiali.

7 Përveç kësaj, gjatë pyetjeve shtesë Mbrojtja është --
8 Mbrojtjes i lejohet që të nxjerrë informacion nga Dëshmitari
9 4842.

10 Në lidhje me çështje specifike, që kanë të bëjnë me
11 kërkesën e Mbrojtjes për nxjerrje materialesh, me kusht që,
12 këtu të përcaktohet rëndësia e çështjes së Mbrojtjes në
13 përputhje me pyetjet.

14 Për këto arsye, Trupi Gjykses, hedhë poshtë kërkesën e
15 përbashkët të Mbrojtjes me kushtin e lartpërmendur.

16 Me kaq përfundon urdhri gojor në lidhje me kërkesën e
17 Mbrojtjes sipas rregullit 102(3).

18 Nuk kam përfunduar ende z. Rees.

19 Trupi Gjykses e shfrytëzon këtë rast që të njoftojë se
20 lista e provave të ZPS-së për dëshmitarin 4842 përmban disa
21 Shënime Zyrtare që nuk i ka -- autor i të cilave nuk është
22 vetë dëshmitari.

23 ZPS-së nuk i ndalohet që të nxjerrë informacion nga ky
24 dëshmitar në lidhje me atë që përmbajnë këto shënime apo
25 shënime të përpiluara nga palë të treta.

1 Sikurse është thënë edhe më herët, me aq sa këto prova
2 nuk bien -- për aq sa këto prova nuk bien nën rregullin 153
3 dhe 154, ato nuk mund të pranohen nëpërmjet këtij dëshmitari.

4 ZPS-ja ka ndërmend të mbështet në shënime që nuk janë
5 përgatitur nga dëshmitari 4842 dhe për këtë arsye, duhet të
6 sigurojë bazën e njohurisë që ai dëshmitar ka në lidhje me to.

7 Urdhëroni tani, z. Rees.

8 Z. REES: [Përkthim] Në kërkesën tonë, ne kemi theksuar se
9 nuk është dhënë një njoftim i përditësuar sipas rregullit
10 102(3), që do të trajtonte materialet që ka Zyra e Prokurorit
11 dhe të cilat janë brenda fushëveprimit të tre paragrafëve, kjo
12 ka të bëjë me informacionin që na është bërë i njohur
13 nëpërmjet korrespondencës me email në datën 14 tetor.

14 Sigurisht, që ky nuk është një informacion krejtësisht i
15 ri. Dhe Prokuroria, në fakt, në përgjigje ndaj parashtimit
16 tonë numër F00349, në atë fazë, na bëri ditur se dëshmitari
17 4842 ishte në gjendje të jepte dëshmi në lidhje me detyrat
18 institucionale që i kishte kryer në kuadër të ekipit të
19 sigurisë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,
21 më falni që po ju ndërpres, cili është qëllimi i kësaj
22 deklarate? A kërkon që të rishqyrtohet diçka apo?

23 Z. REES: [Përkthim] Ne parashtrojmë se ZPS-ja duhet të na
24 japë një listë të përditësuar të rregullit 102(3).

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Po ne,

1 për fat të keq, keni marrë tashmë veprim në lidhje me këtë
2 listë.

3 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e kam të qartë
4 se keni marrë vendim në lidhje me kërkesën për nxjerrjen e
5 materialeve sipas rregullit 102(3). Sidoqoftë, ky rregull
6 sikurse të gjithë e dinë, përfshin tre faza.

7 Faza e parë, është nxjerrja apo dorëzimi i njoftimit të
8 rregullt ku parashikohen të gjitha materialet që ka Prokuroria
9 e Specializuar. Dhe kërkesa për nxjerrje materialesh është
10 vetëm faza e tretë e këtij rregulli.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Ju
12 faleminderit.

13 Z. Prokuror.

14 Z. PACE: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar Gjykatës.
15 Vetëm shkurtimisht.

16 Arsyet për refuzimin e këtyre kërkesave të përsëritura
17 janë të njëjta sikurse ato që përmendet në vendimin tuaj. Dhe
18 kjo është natyra shumë e gjerë apo gjithëpërfshirëse e
19 kërkesës.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Tani do të
21 vazhdojmë.

22 Tani Paneli do të dëgjojë parashtrimet e palëve në lidhje
23 me pranueshmërinë e provave që janë paraqitur por pranimi i të
24 cilave është shtyrë gjatë dëshmisë së znj. Pumper.

25 Palët nuk duhet të përsëritin parashtrime që tashmë i

1 kanë bërë.

2 Palëve do t'ju jepen nga 15 minuta për të bërë
3 parashtrimet e veta në lidhje me të gjitha kategoritë.
4 Prokurorisë do t'i lejohet që të lexojë një përmbledhje të
5 shkurtër të deklaratave të znj. Pumper dhe koha e leximit nuk
6 do të përfshihet në 15 minuta që i jepen Prokurorit.

7 Trupi Gjykues nxjerrë një vendim me shkrim në lidhje me
8 pranueshmërinë dhe klasifikimin e atyre provave pasi t'i ketë
9 dëgjuar argumentet e palëve.

10 Do të fillojmë me Prokurorinë.

11 Znj. Prokurore, ju e keni fjalën.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ju faleminderit, i nderuar
13 Gjykatës.

14 Do të filloj sipas kategorive dhe listës së dokumenteve
15 për të cilat kemi njoftuar palët dhe Trupin Gjykues, do të
16 fillojmë me deklaratën e 4841.

17 ZPS-ja rithekson edhe një herë kërkesën për pranimin e
18 provave të shënuara me numrat P86 MFI, P86 MFI, P88 MFI, P89
19 MFI, P90 MFI dhe P91 MFI sipas rregullit 154. Kërkesa për
20 pranimin e këtyre provave përfshin edhe përkthimet në shqip të
21 këtyre deklaratave të cilat nuk kanë një shënim MFI deri tani.

22 Është bërë shtyrja e vendimit në lidhje me pranimin e
23 këtyre provave. Dëshmitarja ka konfirmuar se ajo ka qenë
24 autorja e këtyre deklaratave, ishte e pranishme në Gjykatë dhe
25 ishte e disponueshme për pyetje nga Mbrojtja dhe për pyetje të

1 Trupit Gjykues dhe konfirmoi se deklaratat reflektojnë atë që
2 e ka thënë në lidhje me këto pika specifike.

3 Për sa i përket kundërshtimeve që janë ngritur nga
4 Mbrojtja në lidhje me këto prova, ato kanë të bëjnë me peshën
5 që do t'u jepet atyre.

6 Klasifikimi i secilës nga këto deklaratat është
7 konfidencial, meqë ato përbëjnë referenca konkrete në lidhje
8 me përmbajtjen e materialeve konfidenciale që janë nxjerrë pa
9 autorizimin e të akuzuarve.

10 ZPS-ja është në dispozicion që të dorëzojë një version të
11 redaktuar publik të versionit në anglisht të çdo deklarate dhe
12 do të jetë e gatshme ta bëjë këtë brenda 10 ditësh nga vendimi
13 i Gjykatësve mbi pranueshmërinë e këtyre provave.

14 Për të siguruar përdorim eficient të burimeve të
15 përkthimit, ZPS-ja kërkon që versionet në shqip të redaktuara,
16 të propozuara për pranim t'i dorëzojë pas redaktimit të
17 versionit në anglisht dhe pas miratimit të Trupit Gjykues.

18 Tani do të bëjë një përmbledhje të deklaratave në fund të
19 çdo parashtrimi.

20 Do të kalojë tek prova P0098 MFI që është një Notë Zyrtare
21 autor i së cilës është Dëshmitari 4841 dhe korrespondenca e
22 bashkëlidhur.

23 Këto tashmë janë dorëzuar si prova bashkë me dëshminë e
24 Dëshmitarit 4841. Ai ka konfirmuar autenticitetin e këtyre
25 Notave Zyrtare dhe të korrespondencës së bashkëlidhur.

1 Autenticiteti i kësaj korrespondence gjithashtu është
2 konfirmuar me dëshminë e dëshmitarit 4866 dje dhe një ditë më
3 parë dhe, theksoj, një pjesë e këtij materiali tashmë është
4 pranuar si prova P00981.

5 E gjithë korrespondenca është e rëndësishme dhe ka vlerë
6 provuese duke qenë se dokumenton ngjarjet sikurse kanë ndodhur
7 në OVL UÇK më 7 shtator 2020 në kuadër të raportimit të
8 KosovaPress-it.

9 Për mendimin e ZPS-së, klasifikimi i provës P0098 MFI
10 duhet të mbetet konfidencial duke qenë se përmban referenca në
11 lidhje me identitetin e palëve të treta dhe mund, për këtë
12 arsye, të ndikojë në të drejtën për privatësi. Redaktimet e
13 propozuar për versionin e redaktuar publik në anglisht tashmë
14 janë parashtruar nga ZPS-ja në parashtrimin e vet me numër
15 F00324, Shtojca 1, të datës 24 shtator 2021.

16 Tani do të kaloj tek kategoria e dytë, pra, Kategoria 2 e
17 dokumenteve ku janë përfshirë fragmente nga Paketa 1. Këto
18 janë dokumentet P93 MFI, P94 MFI, P95, P96 dhe P97, të gjitha
19 të shënuar me MFI në fund.

20 Të gjitha faqet e nxjerra nga Paketa 1, tani janë --
21 autenticiteti i tyre tashmë është vërtetuar nga dëshmitari
22 45841 gjatë dëshmisë së saj dhe janë identifikuar si pjesë e
23 dokumenteve që janë marrë nga zyrat e OVL UÇK-së më 8 shtator
24 2020. Rëndësia dhe vlera provuese e tyre është e dukshme duke
25 qenë se janë fragmente të materialeve konfidenciale që janë

1 nxjerrë nga të akuzuarit më datën 7 shtator 2020, sikurse
2 akuzohen në Aktakuzë.

3 Sikurse kemi thënë edhe më herët dhe duke mbajtur
4 parasysh udhëzimet e Trupit Gjykses në vendimin F00350, në
5 paragrafin 18, ZPS-ja parashtron se klasifikimi i këtyre
6 materialeve duhet të mbetet konfidencial duke qenë se këto
7 procedura nuk duhet të shfrytëzohen për bërjen publike të një
8 informacioni që përmbahet në paketat dhe që nuk është publik.

9 Tani do të kalojmë në Kategorinë 3, do të fillojmë me
10 provën P99 MFI.

11 Në lidhje me këtë dokument dëshmitari 4841 e ka vërtetuar
12 autenticitetin e tij si pjesë e Shënimeve Zyrtare të ZPS-së.
13 dëshmitari 4866, gjatë dëshmisë së vet të dy ditëve të fundit,
14 ka folur në lidhje me vërtetësinë e ngjarjeve që dokumentohen
15 në Shënimin Zyrtar dhe ai është marrë në pyetje edhe nga
16 Mbrojtja, në lidhje me tema të ndryshme duke përfshirë edhe
17 këtë.

18 Ky dokument është i rëndësishëm duke qenë se mbështet dhe
19 vërteton dëshminë e dëshmitarit 4866 në lidhje me dorëzimin e
20 Paketës 4 ZPS-së dhe me vlerën provuese për sa i përket
21 ngjarjeve që dokumenton vetë prova.

22 Klasifikimi i këtij dokumenti është konfidencial duke
23 qenë se ai përmban emrat e zyrtarëve të ZPS-së. Redaktimet e
24 propozuara për versionin publik të redaktuar në anglisht
25 tashmë janë parashtruar nga ZPS-ja në dorëzimin numër 324,

1 Shtojca 1, e datës 24 shtator 2021. Një version më pak i
2 redaktuar i këtij Shënimi Zyrtar do të dorëzohet gjithashtu
3 nga ZPS-ja.

4 Tani do të kaloj tek prova P101 MFI dhe P102 MFI, të
5 cilat do t'i trajtoj bashkërisht.

6 Theksoj se prova P00102 është e rëndësishme për arsyet që
7 i përmendi dëshmitarja 4841 në deklaratën e saj P89 MFI. Kjo
8 është një korrespondencë që ka marrë ZPS-ja që përfshin edhe
9 fotografi të faqeve nga dokumentet nga Paketat 1 dhe 4, të
10 marra nga ZPS-ja nga një shtëpi e mediave. Si i tillë
11 dokumenti mbështet faktin e shpërndarjes së informacionit
12 konfidencial nga ana e të akuzuarve më datën 7 shtator brenda
13 konferencës së shtypit.

14 Dokumenti P00101 dhe Nota Zyrtare e ZPS-së që flet për
15 origjinën e korrespondencës konfirmojnë autenticitetin e
16 kësaj.

17 Autenticiteti i P00101 dhe 102 është trajtuar edhe nga
18 dëshmitari 4841 gjatë dëshmisë. ZPS-ja parashtrohet se këto
19 dokumente duhet të mbeten konfidenciale meqë përmbajnë
20 referenca ndaj identitetit të palëve të treta dhe mund, për
21 këtë arsye, të ndikojnë në të drejtën e privatësisë si dhe
22 zbulojnë identitetin e pjesëtarëve të ZPS-së.

23 Një version publik i redaktuar tashmë është parashtruar
24 nga ZPS-ja dhe ka numrin F00324.

25 Tani do të kaloj Kategoria 4, që përfshin Paketën 2 dhe

1 provën e shënuar me numrin P104 MFI.

2 Theksoj se të gjitha faqet e nxjerra nga Paketa 2 tashmë
3 janë -- autenticiteti i tyre tashmë është vërtetuar nga
4 dëshmitarja 4841 gjatë dëshmisë së saj dhe këto janë dokumente
5 që janë marrë nga OVL UÇK-ja më 16 shtator 2020.

6 Këto dokumente lidhen drejtpërsëdrejti me ngjarjet që
7 pretendohen në Aktakuzë dhe përbëjnë prova materiale të asaj
8 çka është gjetur në posedim të të akuzuarve pas këtyre
9 konferencave, pas konferencës së 16 shtatorit 2020.

10 Përveç redaktimit të gjashtë faqeve duke qenë se
11 përmbajnë informacion konfidencial në lidhje me hetimet e
12 TFHS-së dhe ZPS-së, materialet e tjera nuk lidhen me hetimet e
13 këtyre dy organizatave dhe me Aktakuzat [siç] e paraqitura në
14 Aktakuzë.

15 Kërkojmë nga Trupi Gjykses që të marrë parasysh kërkesën
16 tonë sepse ZPS-ja parashtron që te materialet në Paketën 2 nuk
17 duhet të ngarkohet në këtë format në faqen e internetit të
18 DHSK-së për të pasqyruar politikën e publikimeve online të
19 Gjykatave të Kosovës që nxjerrin gjykime, aktgjykime të tilla
20 publike.

21 Kategoria 5, përfshin fragmente dokumentesh nga Paketa 3.
22 Kjo kategori përfshin të gjitha dokumentet e përfshira në
23 vargun P106 deri në P119 MFI.

24 Të gjitha faqet e nxjerra të Paketës 3, autenticiteti i
25 tyre është vërtetuar nga dëshmia e 4841 dhe vlera e tyre

1 provuese dhe rëndësia e tyre është provuar duke qenë se janë
2 nxjerrje materialesh konfidenciale që janë nxjerrë nga të
3 akuzuarit më datën 22 shtator 2020 dhe të cilat janë dorëzuar
4 ZPS-së po atë ditë.

5 Sikurse kemi theksuar më herët dhe duke marrë parasysh
6 vendimin e Trupit Gjykses me numër F00350, paragrafi 18, ZPS-
7 ja parashton se klasifikimi i këtyre materialeve duhet të
8 mbetet konfidencial duke qenë se janë materiale konfidenciale
9 të shpërndara pa të drejtë pa autorizim nga ana e të
10 akuzuarve.

11 Kategoria 6, përfshin vetëm një dokument. Është dokumenti
12 me numër P126 MFI. Dhe është një letër e një organizate
13 ndërkombëtare që ka marrë ZPS-ja.

14 Origjina e këtij dokumenti është e qartë nga vetë formati
15 dhe përmbajta e dokumentit. Përveç kësaj, ZPS-ja është marrësi
16 i kësaj letre, i kësaj korrespondence, që është pjesë e
17 Shënimeve Zyrtare të ZPS-së sikurse u konfirmua nga
18 dëshmitarja 4841. Ky dëshmitar vërtetoi autenticitetin e kësaj
19 letre.

20 Korrespondenca është e rëndësishme duke qenë se shpjegon
21 kuadrin e bashkëveprimit dhe bashkëpunimit midis ZPS-së dhe
22 dhënësit të informacionit që është ndërkombëtarë dhe sidomos,
23 regjimin konfidencial që kanë materialet e marra nga ZPS-ja
24 nga ky dhënës informacioni.

25 Dokumenti, gjithashtu, përputhet dhe vërteton dëshminë e

1 dëshmitarit 4841 në lidhje me informacionin e përfshirë në
2 Paketën 3 që ishte konfidencial dhe u nënshtrohej kufizimeve
3 që i kishte imponuar pala e tretë.

4 Letra pra, është e klasifikuar si konfidenciale dhe ZPS-
5 ja kërkon që ky klasifikim të vazhdojë edhe më tej, pra, të
6 mbetet në fuqi.

7 Kategoria 7 e dokumenteve, janë parashtrime publike të
8 Dhomave të Specializuar të Kosovës që përmenden në dëshminë e
9 dëshmitarit 4841. Të gjitha këto dokumente janë trajtuar gjatë
10 dëshmisë së dëshmitarit në lidhje me informacionin e mbrojtur
11 të përmbajtur në Paketën 3.

12 Sikurse parashtron ZPS-ja në parashtrimin e vet F00352,
13 datat dhe përmbajtja e Shënimeve Zyrtare publike të Gjykatës,
14 së kësaj Gjykate, janë objekt i njoftimit gjyqësor. Në qoftë
15 se Trupi Gjykes e konsideron të nevojshme që këto parashtrime
16 të paraqiten për pranim si prova, ZPS-ja kërkon që ato
17 formalisht të pranohen njëherë si prova në këtë çështje në
18 kuadër të kësaj procedure. Dhe klasifikimi i këtyre
19 dokumenteve të kategorisë 7 është publik.

20 Në lidhje me kategorinë 8, provat shoqëruese. Së pari, ka
21 disa dokumente që janë trajtuar gjatë dëshmisë së dëshmitares
22 4841 ato janë treguar dëshmitares dhe këto janë dokumentet me
23 numër 46 dhe 45 në listën provave materiale të ZPS-së.

24 Dëshmitarja 4841 ju referua këtyre artikujve dhe
25 përkthimeve gjatë në deklaratën e vet P86. Pranimi i këtyre

1 artikujve të shtypit tashmë është kërkuar nga ZPS-ja në bazë
2 të rregullit 154, ndër provat shoqëruese. Në qoftë se Trupi
3 Gjykues do të kërkojë që kërkesa për pranimin e këtyre
4 materialeve të ritheksohet dhe të paraqitet për çdo dokument
5 veç e veç, atëherë, Prokuroria do ta bëjë këtë.

6 Klasifikimi i këtyre dokumenteve është konfidencial dhe
7 sipas Prokurorisë duhet të mbetet i tillë, duke qenë se
8 përmban referenca dhe fotografi në lidhje me informacion
9 konfidencial të përfshirë në Paketën 3.

10 Redaktimet e propozuara tashmë janë parashtruar nga ZPS-
11 ja në dorëzimin parashtrimin numër F00324.

12 Po këto parashtrime vlejné edhe për dokumentet e
13 shënuara, numërtuara me numrat 50 dhe 51 në listën e provave
14 materiale të ZPS-së. Ky është një artikull shtypi me numrin
15 ERN 081395 dhe 081404 dhe përkthimet në anglisht kanë numrin
16 081395-081389-ET.

17 E njëjta vlen edhe për dokumentet me numrin rendor 55 dhe
18 56 në listën e provave të ZPS-së. Këto janë dokumentet 081414
19 deri në 081415-ET dhe 081414-081422.

20 Dokumenti tjetër në radhë është SITF003714 deri 142.

21 Dëshmitari, gjatë dëshmisë së vet, i është referuar këtij
22 dokumenti të shënuar për identifikim me numrin P86.

23 Dokumenti është trajtuar gjatë marrjes në pyetje të
24 dëshmitares, autenticiteti i dokumentit është vërtetuar nga
25 dëshmitari dhe aty përmenden masat mbrojtëse në lidhje me

1 dëshmitarët, të cilët përmenden me emra dhe pseudonime në
2 Paketën 3.

3 Klasifikimi i këtyre dokumenteve duhet të mbetet
4 konfidencial dhe lidhja midis një urdhri specifik të Gjykatës
5 në lidhje me masat mbrojtëse të nxjerra nga Gjykatat e Kosovës
6 në rast konkret dhe Paketës 3 e zmadhon më shumë rrezikun e
7 identifikimit të dëshmitarëve të ZPS-së dhe dëshmitarëve të
8 mundshëm të ZPS-së që përmenden në Paketën 3.

9 Ka dhe tre dokumente të tjera që ka identifikuar Trupi
10 Gjykues.

11 Theksoj se brenda kësaj kategorie edhe dokumentet e
12 numërtuara me numrat 52 deri në 54 në listën e provave të ZPS-
13 së duhet të përfshihen duke qenë se dëshmitari ka konfirmuar
14 se i ka parë ato dokumente dhe këtë e ka bërë në dëshminë e
15 saj të 19 tetorit 2021 dhe kjo është në faqen 980 të
16 transkriptit.

17 Për të gjitha këto dokumente parashtrimet e ZPS-së janë
18 të njëjta dhe do të përmendim vetëm numrat e këtyre
19 dokumenteve. Këto janë dokumente në numrat rendor 47 dhe 49 në
20 listën e provave materiale të ZPS-së, veçanërisht, videoklipi
21 me numrin 081392-01 si dhe transkripti në shqip dhe anglisht;
22 prova me numër 57 në listën e provave materiale të ZPS-së i
23 referohet videoklipit shënuar me numrin 081422-01 dhe
24 transkripti në anglisht dhe shqip të këtij videoklipi dhe në
25 fund videoincizimi me numrin ERN 081405-01, duke përfshirë

1 edhe transkriptet në anglisht dhe në shqip që lidhen me
2 dokumentet 52 dhe 54 në listën e provave materiale të ZPS.

3 Të gjitha këto video materiale janë përmendur në
4 deklaratën e dëshmitares W04841 dhe janë shënuar me numrin e
5 identifikimit P86, autenticiteti dhe rëndësia e këtyre
6 materialeve është theksuar nga vetë dëshmitarja në deklaratën
7 e saj dhe gjatë dëshmisë së saj. Këto janë të gjitha video që
8 përmbajnë informacion dhe fotografi të materialeve të Paketës
9 3.

10 Klasifikimi i të gjithë këtyre artikujve duhet të jetë
11 konfidencial dhe ZPS-ja ndërkohë ka propozuar redaktimet në
12 parashtrimin e saj F00324, Shtojca 1.

13 Së fundi, është edhe dokumenti i fundit, që është një
14 provë materiale që lidhet me deklaratën e dëshmitares me numër
15 MFI P88. Dhe është dokumenti 078981 deri 0789782 bashkë me
16 përkthimin në anglisht. Këto janë faqe të përfshira në Paketën
17 4 dhe që dëshmitarja 4841 identifikoi në deklaratën e saj me
18 shkrim që ka natyrë tjetër nga materialet konfidenciale të
19 përfshira në Paketën 4.

20 Këto dy faqe janë nxjerrë dhe për këtë arsye është
21 kërkuar pranimi i tyre sipas rregullës 104. Unë e theksoj,
22 nëse është nevoja, kërkesën për t'i pranuar këto dy dokumente.

23 Dokumenti është vërtetuar nga dëshmitarja dhe ka rëndësi
24 sepse jep kontekstin, e bën informacionin e qartë, përfshirë
25 në informacionin e përfshirë në deklaratën e saj dhe

1 përfshihet në deklaratën e saj dhe është pjesë e materialeve
2 që ZPS-ja mori nga gazeta inFokus.

3 Faleminderit.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
5 Gaynor ka nja dy pyetje.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit shumë z.
7 Kryetar.

8 Znj. Bolici, sa për t'ju kujtuar atë punën e redaktimeve
9 të propozuara. Siç tha Kryetari, në fillim të kësaj seance,
10 gjyqi është gjyq publik. Të akuzuarit kanë të drejtë të kenë
11 një gjyq publik. Dhe një aspekt i gjyqit publik është që të
12 gjitha provat materiale të pranuar të jenë të qasshme nga
13 publiku, të disponueshme për publikun.

14 Prandaj, lidhur me redaktimet që propozoni, duhet t'ju
15 kujtoj, që këto redakte t'i mbani absolutisht në minimum. E
16 keni të qartë?

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Për redaktimet që i kemi
18 paraqitur, ne vazhdojmë të mendojmë që janë redaktimet e
19 propozuara dhe donim t'jua vinim në vëmendje.

20 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Disa pyetje lidhur me
21 kategorinë 4, që është Paketa 2.

22 Në parashtrimet tuaja sot, na kujtuat se përveç gjashtë
23 faqeve, që janë plotësisht të redaktuara, pjesa tjetër e P104
24 MFI, që është Paketa 2, mund të pranohej si dokumente publike.

25 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në rregull. Shkurtimisht në
2 qoftë se s'jeni e përgatitur mos u përgjigjuni tani, po të
3 lëmë mënjane gjashtë faqet plotësisht të redaktuar, çfarë
4 krimi është kryer duke e nxjerrë publikisht pjesën tjetër të
5 Paketës 2?

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Aktakuza nuk përfshin pjesën e
7 mbetur të Paketës 2.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Pra, krimi përqendrohet në
9 gjashtë pjesët apo faqet e redaktuara plotësisht të Paketës 2?

10 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Aktakuza i referohet përhapjes
11 së materialeve konfidenciale në 16 shtator. Paketa 2, përfshin
12 materialet që ZPS-ja i konfiskoi në 17 shtator.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Për sa i takon krimin të
14 kryer thelbi i krimin është ka të bëjë me këto gjashtë faqe
15 këtë po thoni?

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Gjashtë faqet janë ato materiale
17 që ZPS-ja mundi t'i marrë. Ka informacion bazuar në
18 konferencat për media dhe deklaratat e të akuzuarve se
19 materialet e shpërndara në shtyp dhe në publik i tejkalojnë
20 materialet që mori ZPS-ja të nesërmen.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shqetësimi që kam unë është
22 se as Trupi Gjykses, as Mbrojtja, nuk kanë mundësi t'i këqyrin
23 këto gjashtë faqe plotësisht të redaktuara dhe këto janë në
24 fakt pikërisht ato faqe që përbëjnë esencën, thelbin e krimin
25 për aq sa ju jeni në gjendje të paraqisni prova për atë krim.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Gjashtë faqet janë adresuar në
2 deklaratat e dëshmitares 4841 dhe përmbajtja e këtyre faqeve
3 është vërtetuar gjatë dëshmisë së saj përpara Trupit Gjykses.
4 Gjashtë faqet janë subjekt apo objekt i urdhrorit për masa
5 mbrojtje të lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

6 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe kjo na sjell te thelbi
7 i çështjes dhe kjo është. Këto gjashtë faqe në vetvete,
8 sigurisht, nuk kanë vlerë vërtetuese. Gjashtë faqe me bojë të
9 zezë nuk kanë ndonjë rëndësi. Nuk ka vlerë provuese.

10 Pra, ne si Trup Gjykses jemi përpara provave të
11 dëshmitares Pumper për këto gjashtë faqe; kështu është?

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Trupi Gjykses i keni gjashtë
13 faqet në kuptimin që janë pjesë e procesverbalit të paraqitura
14 Gjykatësit të Procedurës Paraprake kur është bërë e qartë.

15 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Ta bëjmë të qartë.

16 Gjashtë faqet e paredaktuara, nuk janë pranuar si prova.
17 Nuk janë paraqitur nga ju. Ato nuk bëjnë pjesë në
18 procesverbalin në të dhënat e gjyqit. Pra, ky Trup Gjykses nuk
19 mund të mbështetet në versione të paredaktuar të këtyre
20 gjashtë faqeve. E kuptoni?

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] E kuptoj. Mënyra sesi
22 informacioni për përmbajtjen e këtyre gjashtë faqeve si është
23 prezantuar kjo është bërë përmes deklaratës, dëshmisë së
24 dëshmitares, e cila i ka këqyrur këto gjashtë faqe dhe ka
25 konfirmuar përmbajtjen e këtyre gjashtë faqeve.

1 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Shumë mirë.

2 PËRKTHYESJA: [Përkthim] Flisni më afër mikrofonit.

3 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe tani përqendrohuni tek
4 koncepti i njoftimit gjyqësor.

5 Sipas Rregullores së Procedurës dhe Provave këto
6 njoftimet zyrtare gjyqësore përfshijnë ose njoftimin gjyqësor
7 apo faktet e gjykuara. Këtu Prokuroria ka parashtruar se këto
8 materiale, që ajo thotë se janë të dukshme nga ana gjyqësore,
9 janë nga ana gjyqësore të qarta si fakte që dihen, njihen.

10 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A ka diçka që të dallojë
11 këto parashtrime publike të kësaj Gjykate nga ndonjë dokument
12 i nxjerrë nga një ministri apo gjykatë e një vendi tjetër,
13 pra, çfarë i bën këto fakte më të pranueshme sesa parashtrimet
14 e çdo subjekti tjetër në botë?

15 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Autenticiteti i parashtrimeve
16 është, -- mendoj që nuk vihet në diskutim. Po rëndësia e këtij
17 parashtrimi ka dalë nga dëshmia e 4841. Ajo u mbështet në këto
18 parashtrime lidhur me informacionin që ka dhënë për materiale
19 konfidenciale të përfshira në Paketën 3.

20 Nëse është e nevojshme për një kërkesë zyrtare për t'i
21 pranuar këto parashtrime si parashtrime që lidhen me dëshminë
22 e 4841, ne jemi të gatshëm ta bëjmë një kërkesë të tillë. Në
23 fakt, unë e bëra.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Po, po. E mbajtmë shënim.
25 Ju kërkuat pranimin e këtyre parashtrimeve si prova dhe ne do

1 e shqyrtojmë atë opsion.

2 Nuk kam pyetje të tjera. Faleminderit z. Kryetar.

3 Faleminderit znj. Bolici.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

5 Znj. Bolici, ju nuk përmendët atë dokumentin e vetëm të
6 kategorisë 9, me numër 1D1. Mbase do të mund ta sqaroni.

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mbrojtja kërkoi që ta paraqiste
8 këtë dëshmi, intervistën e dëshmitarit nëpërmjet dëshmisë së
9 4841, e cilën shpjegoi se nuk ka kompetencë për të folur për
10 këto dokumente. Prandaj qëndrimi i ZPS-së është, që Mbrojtja
11 nuk ka përcaktuar rëndësinë e këtij dokumenti.

12 Prandaj duhet të mos pranohet.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Së dyti,
14 tani është koha për ju që të përmbledhni deklaratat e znj.
15 Pumper.

16 Keni parasysh përkthyesit kur flisni.

17 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Do të filloj me përmbledhjen e
18 deklaratës me numër MFI P86.

19 Dëshmitarja 4841 deklaroi se i shqyrtoi, i këqyri
20 dokumentet e sekuestruara në OVL UÇK në 8 shtator 2020.

21 Paketa 1.

22 Dëshmitarja 4841 thotë se Paketa 1 përfshin dokumente
23 konfidenciale që kanë të bëjnë me hetimet e Task Forcës
24 Hetimore Speciale dhe Zyrës së Prokurorisë së Specializuar, ku
25 përfshihen emra, detaje personale të dëshmitarëve dhe

1 dëshmitarëve të mundshëm.

2 Dëshmitarja 4841 deklaron më tej se artikujt e medias që
3 përmenden në këtë deklaratë riprodhojnë informacionin që
4 përmban Paketa 1.

5 Dëshmitarja 4841 thotë se ajo i ka këqyrur dokumentet të
6 cilat u sekuestruan në OVL UÇK në 17 shtator të 2020.

7 Paketa 2.

8 Dëshmitarja 4841 thotë se Paketa 2 përfshin gjashtë faqe
9 dokumentesh konfidenciale që kanë të bëjnë me hetimet e TFHS-
10 së ZPS-së që po ashtu përmbahen në Paketën 1.

11 Dëshmitarja 4841 thotë se ajo i ka këqyrur dokumentet e
12 sekuestruara në OVL UÇK në 22 shtator 2020.

13 Paketa 3.

14 [Dëshmitarja] 4841 thotë se Paketa 3 përfshin dy kopje të
15 paplota të një dokumenti konfidencial të ZPS-së që lidhet me
16 hetimet e saj ku përfshihen emra dëshmitarësh dhe dëshmitarësh
17 të mundshëm.

18 [Dëshmitarja] 4841 deklaron më tej se publikimet në media
19 që përmenden në këtë deklaratë riprodhojnë informacion që
20 përmban Paketa 3.

21 Tani kalojmë te deklaratata që mban datën 9 shkurt 2021,
22 P88 MFI.

23 Në këtë deklaratë 4841 jep hollësi të mëtejshme për disa
24 dokumente, jo në gjuhën angleze, që përfshihen në Paketën 1.

25 Kalojmë tek deklaratata me datën 17 shkurt 2021 e cila

1 është P89 MFI.

2 Në këtë deklaratë, Dëshmitarja 4841 thotë se i ka këqyrur
3 dokumentet që ju dorëzuan ZPS-së nga një organ media në 9
4 shtator 2020.

5 Paketa 4.

6 [Dëshmitarja] 4841 deklaron se përmbajtja e Paketës 1 dhe
7 4 janë të mbivendosura në një masë të madhe.

8 Dëshmitarja 4841 deklaron se i ka këqyrur dokumentet e
9 dërguar ZPS-së me email nga organi i medias në 7 shtator 2020.

10 Dëshmitarja 4841 deklaron se këto dokumente riprodhojnë
11 faqet që përmbajnë faqet 1 dhe/ose 4.

12 Tani kalojmë tek deklarata e 7 majit 2020 me numër P90
13 MFI.

14 [Dëshmitarja] 4841, në Shtojcën 1 dhe 3 të kësaj
15 deklaratë, jep informacion të hollësishëm prej secilit prej
16 dokumenteve që përmbahen në Paketën 1 dhe 2 përkatësisht; dhe
17 në veçanti gjuhën, titullin, përshkrimin dhe origjinën,
18 autorin e dokumenteve, një listë të indikacioneve që tregojnë
19 konfidencialitetin e dokumenteve edhe nëse dokumenti përfshin
20 emra të dëshmitarëve të mundshëm.

21 [Dëshmitarja] 4841 i jep, në Shtojcën 2 dhe 4 të kësaj
22 deklaratë, pamje të pjesëve të dokumenteve që ka paketa 1 dhe
23 2 përkatësisht, që përbëjnë kampion të treguesve që sugjerojnë
24 konfidencialitetin siç janë logo, ato emblemat, vulat dhe
25 shënime të ndryshëm.

1 [Dëshmitarja] 4841 thotë se Paketa 3 përfshin dy kopje të
2 paplota të një dokumenti konfidencial të ZPS-së që lidhet me
3 hetimet e ZPS-së, përfshirë emra të afërsisht 150 dëshmitarëve
4 apo dëshmitarëve të mundshëm.

5 [Dëshmitarja] 4841, në Shtojcën 5, jep pamje të pjesëve
6 të Paketës 3 që përshin indicje të cilat tregojnë
7 konfidencialitetin.

8 Tani kalojmë tek deklarata e 7 majit 20221 me numër MFI
9 P91.

10 Dëshmitarja 4841 jep, në shtojcën 1, informacion të
11 detajuar për secilin prej dokumenteve konfidenciale që përmban
12 Paketa 4. Dhe, në veçanti, gjuhën, titullin, përshkrimin,
13 origjinën dhe autorin e dokumentit dhe një listë që janë një
14 listë indicjesh, treguesish, pra, që tregojnë se dokumentet
15 janë konfidencialë për shkak se përfshijnë emrat e
16 dëshmitarëve potencialë të mundshëm apo që përmbahet në
17 Paketën 1.

18 Dëshmitarja, në shtojcën 2, jep foto të disa dokumenteve
19 të Paketës 4 që përbëjnë një kampion të indicjeve që tregojnë
20 konfidencialitetin e këtyre dokumenteve siç janë emblema, vula
21 dhe/ose shënime të ndryshme.

22 Dhe së fundi, deklarata e nënshkruar e 14 tetorit 2021 që
23 ka numër P87 MFI bën disa korrigjime dhe sqarime të vogla në
24 lidhje me deklaratat e saj të mëparshme.

25 Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Rees,
2 znj. Bolici përdori pak më shumë -- pati më shumë kohë prandaj
3 po ju lëmë 25 minuta dhe juve.

4 Z. REES: [Përkthim] Ju jam mirënjohës.

5 Në parashtrimin tonë të parë, është se tërësia e dëshmisë
6 së znj. Pumper, qoftë me gojë, qoftë edhe me dokumente duhet
7 përjashtuar, nuk duhet të pranohet sipas rregullit 138(1).

8 Rregulli 138(1) parashikon se:

9 "Dëshmia nuk duhet të pranohet në qoftë se vlera provuese
10 është me vogël sesa efekti dëmtues".

11 Unë do të mbështetem në rregullin 138. Në lidhje me
12 dokumentet vetë, në fakt, shkak për, baza për pranueshmërinë
13 nuk është vërtetuar.

14 Në lidhje me parashtrimin e parë, znj. Pumper u thirr në
15 emër të ZPS-së dhe dëshmoi për të përmbledhur, në fakt,
16 përmbajtjen e katër, -- siç i quan ajo, Paketat 1, 2, 3, 4,
17 shumica e të cilave nuk janë prodhuar si dokumente, si prova
18 materiale, Trupi Gjykues nuk qasje në to për të bërë
19 vlerësimet e tyre as Mbrojtja gjithashtu nuk është në gjendje
20 t'i këqyrë t'i kontrollojë pohimet e saj lidhur me përmbajtjen
21 e tyre, të këtyre dokumenteve.

22 Ajo u thirr dhe ka përmbledhur këto dokumente. Vetë akti
23 i përmbledhjes së dokumenteve nënkupton dhënien e opinioneve
24 lidhur me përmbajtjen e tyre. Dhe kjo mund t'i referohet
25 çështjes së Perisiçit, Prokurori kundër Perisiçit. Trupi

1 Gjykues ka prova lidhur me një parashtrim të mëparshëm, që do
2 t'i kërkoj ta shohë ka numrin F00313.

3 Pra, znj. Pumper jo vetëm përmblodhi përmbajtjen, akt i
4 cili përfshin marrjen e vendimeve të cilat tiparet e
5 dokumenteve për të raportuar. Pra, është një përzgjedhje nga
6 ana e dëshmitares e dokumenteve që ajo mendon se kanë rëndësi
7 për t'ia paraqitur Trupit Gjykues, pa marrë parasysh faktorë
8 të tjerë.

9 Ajo shkoi aq larg duke përshkruar, jo vetëm që përshkroi
10 përmbajtjen e dokumenteve por bëri pohime lidhur me
11 konkluzionin, pra, që e përmblodhi znj. Bolici, ajo
12 vazhdimisht ka përsëritur se paketat që nuk janë prodhuar
13 përmbajnë informacion konfidencial. Dhe kjo ka të bëjë me
14 nxjerrjen një konkluzioni për këto dokumente.

15 Ajo është palë e palës hetimore. Dhe për mendimin tonë
16 nuk ka të drejtë të japë mendime apo të nxjerrë konkluzione
17 lidhur me përmbajtjen e këtyre dokumenteve. Dokumente me të
18 cilat është familjarizuar vetëm sepse i ka këqyrur, i ka parë
19 në kuadër të punës së saj me kërkesë të Prokurorisë. E bëri të
20 qartë në dëshminë e saj. Ajo më parë nuk kish pasur ndonjë
21 lidhje me këto dokumente. Dhe ne mbështetemi tek vendimi i,
22 Prokuroria kundër Parisiç për t'u mbështetur përfundimin tonë
23 se ajo nuk mund të nxjerri përfundime konkluzione për këto
24 dokumente në këto rrethana.

25 Dhe parashtrojmë se kur përgatitet një përmbledhje e një

1 dokumenti të tillë nga një palë e cila do ta përdorë, kjo nuk
2 duhet quhet i besueshëm kur materiali nuk është provë
3 materiale përpara Trupit Gjykses i cili mund të marrë mendim.
4 Që Trupi Gjykses të mbështetet mbi një përmbledhje të tillë
5 dhe të nxjerri vlerësimin e saj perceptimi publik i publikut
6 do të ishte se një vendim i tillë do ishte i pasigurt.

7 Dhe këto janë fjalët e Trupit Gjykses të Apelit në rastin
8 e Millosheviçit, referenca gjendet në poshtëshënimin 7,
9 parashtrimi F00317.

10 Dhe ne mendojmë se kjo është situata ku Gjykata e gjen
11 veten duke pasur prova, dëshmi të tilla si ajo e znj. Pumper.
12 Nuk është një vlerësim i pavarur.

13 Dokumentet duhet të ishin prodhuar nga Prokuroria për
14 Trupin Gjykses që mund t'i shikonte, t'i vlerësonte vetë.
15 Pohimet lidhur me përmbajtjet e Paketës 1, 2, 3, 4, nuk
16 pranohen si të sakta dhe të besueshme. Në mungesë të nxjerrjes
17 së tyre dhe të prodhimit të vetë dokumentit pohimet e saj nuk
18 kanë vlerë më të madhe provuese sesa ato të znj. Bolici në
19 emër të Prokurorisë lidhur me përmbajtjen e tyre.

20 Ne, në fakt, e dimë tani se deklaratat e saj janë
21 prodhuar me kërkesë të Prokurores vetë.

22 Lidhur me shqyrtimin shumë të kufizuar nga ana e saj të
23 dokumenteve, ne jo vetëm që nuk jemi në gjendje të
24 kundërshtojmë pohimet e saj lidhur me përmbajtjen e
25 dokumenteve, por nuk jemi në gjendje, nuk mund të bëjmë asnjë

1 kontroll tjetër që mund të ishte me rëndësi të cilin
2 dëshmitarja nuk e mori parasysh ta bënte dhe nuk e bëri. Ajo
3 tani pranon se nuk ka bërë ndonjë kontroll lidhur me
4 autoritetin e personave që po përmenden aty për t'i quajtur
5 dokumentet si konfidencial. Ajo nuk kishte dijeni, kur bëri
6 shqyrtimin se autenticiteti i këtyre dokumenteve ishte një
7 problem. Dhe se ishte e sigurtë dhe pranoi se nuk mund të
8 thuhet se është bërë në këqyrje e plotë e autenticitetit të
9 tyre. Ajo e tha faqen e transkriptit 1069.

10 Ajo e bëri të qartë se dëshmia e saj nuk përcakton ndonjë
11 raportim lidhur me përfshirjen e personave që nuk dhanë
12 informacion. Ajo nuk bëri kontrolle lidhur me dëshmitarë apo
13 dëshmitarë të mundshëm që ishin identifikuar publikisht nga
14 autoritetet serbe p.sh., apo nga gjykata të tjera apo nga vetë
15 dëshmitarët. Referenca është tek transkripti, faqe 1089, faqe
16 1313, 1315, 1316 deri në 1321 dhe 1326.

17 Ajo nuk bëri kontrolle të asnjë nga emrave që ajo për të
18 cilët raportoi dhe Mbrojtja nuk mund ta eksplorojë më tej
19 çështjen në interesin publik lidhur me këto emra. Dhe
20 referenca është në transkript në faqen 1098 deri 1099.

21 Ajo nuk bëri asnjë kontroll nëse urdhrat, peticionet,
22 kërkesat, që dëshmitarja pohoi shpinin në barazinë e
23 konfidencialitetit lidhur me emrat e panxjerrë nëse këto ishin
24 ndryshuar më pas apo ishin shfuqizuar apo ndryshuar. Referenca
25 është në transkriptin në faqen 1338.

1 Ajo nuk bëri asnjë kontroll, qoftë edhe kontrollin më të
2 thjeshtë p.sh., për të parë datat e letrave nga organizatat
3 ndërkombëtare të cilët dëshmitarja pohoi [që] i dhanë e
4 siguruan për konfidencialitetin emrave të panxjerrë për të
5 parë p.sh., nëse ngjarjet përpara apo pas shtatorit 2020. Edhe
6 faqja në transkript është 1338.

7 Në të njëjtën faqe të transkriptit, ajo pranoi se nuk
8 kishte bërë asnjë kontroll lidhur me ndonjë prej letrave nga
9 organizata ndërkombëtare që ajo pohoi këtu i bënë ato
10 konfidenciale, pra, emrat e panxjerrë, në qoftë se këto ishin
11 përpara shtatorit 2020, nëse ishin kishin qenë objekt i ndonjë
12 ndryshimi apo hiqje dorë prej këtyre organizatave më vonë.

13 Në mungesë të nxjerrjes së dokumenteve, të emrave, letra
14 të tilla nga organizatat ndërkombëtare p.sh., kontrolle të
15 cilat nuk mund t'i bëjë dot Mbrojtja dhe Trupi Gjykses është
16 në pozitë, siç parashtrojmë ne, se ZPS-ja i kërkon Trupit
17 Gjykses thjesht t'i pranojë këto pohime të dëshmitares, të
18 dëshmitarëve, që paketat përmbajnë informacion konfidencial pa
19 bërë ndonjë kontroll të tyre.

20 Pra, parashtrimi ynë i parë është se parashtrimi i znj.
21 Pumper, në tërësinë e vet duhet përjashtuar, nuk duhet
22 pranuar. Sepse vlera provuese është më e vogël sesa efekti
23 dëmtues në rrethana për të cilat po flasim.

24 Në lidhje me dokumente konkrete. Ne kundërshtojmë
25 deklaratat dhe Notat Zyrtare të dëshmitares. Parashtrimet që

1 bëjmë ne lidhur me dëshminë e saj gojore me padrejtësinë e
2 pranimit të dëshmisë së saj të përmbledhur në dokumente të
3 cilat nuk janë paraqitur si prova materiale në Gjykatë vlejné
4 edhe për deklaratat me shkrim.

5 Gjithashtu, në qoftë se dëshmia gojore e saj pranohet, ne
6 do të parashtrojmë se në këto rrethana nuk ka kuptim të
7 pranohen edhe deklaratat si prova materiale. Nuk është se ZPS-
8 ja kërkoi t'i pranoni këto dokumente sipas rregullit 154 dhe
9 pastaj, efektivisht e solli dëshmitaren për kundërpjetje. Ajo
10 e solli dëshmitaren të dëshmonte për dy ditë duke folur për
11 çështje që që përcaktohen në deklaratë.

12 Pra, ne parashtrojmë se do të ishte e pavend në këto
13 rrethana të marrësh deklarata të cilat në fakt janë përsëritje
14 të dëshmisë së saj të drejtpërdrejtë.

15 Për më tepër, ato përmbajnë shtojca të cilat ajo i
16 prodhoi, pra, -- parashtrojmë përsëri në padrejtësinë e
17 dëshmisë së saj në përgjithësi të cilat vlejné edhe për
18 shtojcat.

19 Konstatojmë gjithashtu, se me gjithë gjatësinë e tyre,
20 gjatë dy ditëve të pyetjeve kryesore që i bëri Prokuroria, nuk
21 kërkoi t'i shikonte, t'i hulumtonte më tej me dëshmitaren me
22 hollësi me asnjë hollësi. Pra, ne themi, gjithashtu, se
23 parashtrimi apo pranimi i këtyre shtojcave të gjata, ku
24 dëshmitarja foli për dy ditë ju përgjigj pyetjeve pa u
25 përpjekur fare t'i trajtonte këto shtojca, është e padrejtë.

1 Atëherë, lidhur me dokumentin P98 MFI, ne themi që pjesa
2 e mbetur e këtij njoftimi, e këtij shënimi publik merret me
3 çështje të cilat shkojnë përtej njohurisë së drejtpërdrejtë të
4 dëshmitares. Dhe Gjykata ka vendosur që Notat Zyrtare dhe
5 provat e dëshmitarëve duhet të merren me çështje të cilat
6 njihen prej dëshmitares. Ndërkohë që përmbajtja e Notave
7 Zyrtare nuk është pjesë e kësaj.

8 Sa i takon kategorisë 2, fragmenteve të Paketës 2. Këto
9 janë dokumente të cilat ne i kemi parë. Janë dokumente të
10 cilat thuhet që kanë ardhur si pjesë e dokumenteve që
11 dëshmitari e ka etiketuar si pjesë e Paketës 1, megjithatë ne
12 ngremë çështjen e vijimësisë, të vazhdimësisë të cilën e kemi
13 ngritur dhe më përpara në parashtrimin e protokolluar F00317.

14 Neve na atë kohë ngritëm si shqetësim që ZPS-ja nuk duket
15 sikur synon që të thërrasë prova për të provuar origjinën,
16 rëndësinë dhe zinxhirin e kontrollit për sa i takon Paketës 1,
17 2, 3, dhe 4 dhe ndërkohë sa i takon deklaratave të znj. Pumper
18 ato janë përshkruar me shkrim dore dhe nuk janë identifikuar
19 si prova të cilat janë futur në qese plastike dhe të cilat
20 mbajnë të gjitha elemente të tjera, të cilat janë të
21 rëndësishme për sa i takon caktimit të një numri të provës
22 materiale.

23 Pra, me fjalë të tjera, ZPS-ja nuk mund të thotë që nuk
24 është njoftuar se çështja e vazhdueshmërisë është një çështje
25 sa i takon kësaj çështjeje. Sa i takon asaj çfarë tha znj.

1 Pumper në dëshminë e saj, pra, ajo na dha -- nuk na dha detaje
2 qeseve të provave materiale lidhur me dokumentet e paketës 1,
3 2, 3 dhe 4, nuk na tha gjë lidhur me origjinën e dokumenteve
4 nga kanë ardhur këto dokumente.

5 Ndërkohë unë jam në dijeni që ka një kërkesë të ZPS-së që
6 është pezull akoma dhe kërkohet shtimi i një personi tjetër në
7 listën e dëshmitarëve dhe mund të merret me sekuestrimin e
8 dokumenteve në nivelin e parë dhe do përfshihen gjithashtu
9 edhe sekuestrimet e dokumenteve në të cilat janë sekuestruar
10 në terma më të përgjegjshme ndërkohë që nuk është se do jepen
11 detaje si p.sh., numri apo prova të cilat janë futur në qeset
12 për provat materiale.

13 Znj. Pumper tha, se pavarësisht se çfarë mund të thotë,
14 pra, dëshmitari, ndërkohë provat e dëshmitares kanë thënë që
15 nuk është se e kanë ndihmuar shumë Gjykatën dhe nuk kanë dhënë
16 hollësi të tjera lidhur me origjinën e dokumenteve të cilat
17 janë pjesë e Paketës 1, 2, 3, ose 4 dhe në veçanti lidhur me
18 paketat apo qeset e provave që janë vendosur në këtë çantë të
19 madhe.

20 Sa i takon Paketës 1, 2 dhe 3 nuk ka vijimësi dhe
21 rëndësia e këtyre provave nuk është vërtetuar në nivelin e
22 parë.

23 Sa i takon kategorisë 3, që ka të bëjë me njoftimet
24 Zyrtare për marrjen e informacioneve nga media. Dokumentet P99
25 MFI dhe P101 MFI kanë si autor dy nëpunës të tjerë të ZPS-së.

1 Në të regjistrohen ngjarje në të cilat nuk ka qenë e përfshirë
2 kjo dëshmitare. Pavarësisht kujtesës së Trupit Gjykses, vetëm
3 pak momente më përpara, pra, neve sa i takon pranueshmërisë së
4 këtyre çështjeve dhe ne duam që të themi që pavarësisht, le të
5 themi, çështjes së ngritur nga Trupi Gjykses, ZPS-ja pra,
6 kërkon që këto të jenë Njoftime Zyrtare, Shënime Zyrtare të
7 cilat pranohen nga Trupi Gjykses. Ndërkohë që këto janë të
8 dhënat të cilat janë marrë nga një dëshmitar janë dokumente të
9 prodhuara nga persona të cilët nuk është se kanë qenë
10 dëshmitarë për të dëshmuar për dokumentet në fjalë dhe lidhur
11 me to znj. Pumper nuk mund të japë dëshmi që kanë të bëjnë me
12 vërtetësinë apo me përmbajtjen e tyre.

13 I njëjti pozicion lidhet dhe me dokumentin P102 MFI.

14 Sa i takon kategorisë 6, korrespondenca nga organizatat
15 ndërkombëtare. Me siguri sa i takon dokumentit të parë
16 rëndësia e këtij dokumenti është tërësisht e paqartë, pra,
17 është një dokument i cili mban datën gjashtë muaj pas
18 ngjarjeve të cilat trajtohen në këtë seancë, në këtë çështje.

19 Sa i takon korrespondencës tjetër, ne mendojmë që
20 rëndësia e atyre letrave nuk është vërtetuar dhe duke qenë që
21 kemi mungesë të dokumenteve të cilat tregojnë që përfshijnë
22 çështjet e konfidencialitetit. Neve e kuptojmë qëllimin e
23 referimit ndaj këtyre letrave dhe qëllimi ishte znj. Pumper,
24 të thoshte që letra A, pra, përcakton cilësinë e
25 konfidencialitetit me materialet të cilat gjenden në paketën

1 B.

2 Neve e kuptojmë qëllimin. Dhe në mungesë të prodhimit të
3 provave të dokumentit B, në këtë rast letra A nuk ka rëndësi.
4 Dhe për këtë arsye do të duhet që të mos pranohet.

5 Ne nuk e konsiderojmë që parashtrimet janë në aspektin
6 gjyqësor të njoftueshëm. Pra, ne mendojmë që ky është
7 keqpërdorim i parimit që e lejon Gjykatën që të marrë parasysh
8 çështjet e njoftimit gjyqësor. Në qoftë se ato do të duhet që
9 të -- në to do të duhet të mbështetemi do të duhet që ato të
10 pranohen siç duhen si prova materiale.

11 Sa i takon kategorisë 8, pra, që janë provat materiale.
12 Të lidhura për aq kohë sa artikujt e shtypit referohen si
13 prova materiale, në qoftë se dëshmia me gojë e znj. Pumper,
14 nuk përjashtohet, ne nuk kemi kundërshtim të madh që këto
15 dokumente që referohen si prova, të jenë prova materiale,
16 megjithatë, ne mendojmë apo ne parashtrojmë që këto prova
17 materiale nuk janë të referuara në dëshminë e dëshmitarit dhe
18 si të tilla nuk duhet të pranohen.

19 Në fund, sa i takon kategorisë 9. Intervista, sigurisht,
20 është një dokumenti i cili është nxjerrë nga ZPS-ja. Është
21 për gatitur nga ZPS-ja. I është treguar dëshmitares. Ne nuk
22 kërkuam që ky dokument të ofrohej.

23 Ne do ta trajtojmë pranueshmërinë e këtij dokumenti në
24 një fazë të mëvonshme në gjykim kur të trajtojmë gjithashtu
25 edhe pranueshmërinë e provave të tjera të dëshmitarëve që do

1 të pasojnë. Unë e di që Trupi Gjykses ka inkurajuar palët në
2 këtë proces që të përdorin mocionet e paraqitjes së provave
3 drejtpërdrejtë edhe, sigurisht, do ta kemi parasysh këtë në
4 kohën e duhur kur të vij momenti.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Z. Cadman,
6 keni rreth 20 minuta në dispozicion. Janë të mjaftueshme kjo
7 kohë për ju apo jo?

8 Z. CADMAN: [Përkthim] Pjesa më e madhe e çështjeve u
9 mbulua nga z. Rees.

10 Ajo çfarë mund të them unë lidhur me dokumentet e
11 kategorisë 1, unë jam plotësisht dakord me parashtrimin e z.
12 Rees lidhur me tërësinë e provave të znj. Pumper. Pra, ky
13 është i njëjti pozicion që kemi ne, si Mbrojtje e z. Haradinaj
14 dhe e mbështes plotësisht parashtrimin e tij, kështu që, nuk
15 ja vlen ta përsëris atë çfarë tha z. Rees.

16 Mbi bazën e deklaratave, po kërkoja fjalën e duhur. Pra,
17 të deklarimeve që ka bërë znj. Pumper, siç e tha me të drejtë
18 z. Rees, ajo ka dhënë prova të gjata, si gjatë marrjes së
19 drejtpërdrejtë nga ZPS-ja, po gjithashtu edhe gjatë marrjes së
20 në pyetje nga ana jonë. Dhe provat e saj, ajo çfarë ka thënë
21 ajo nën betim si gjatë pyetjes së drejtpërdrejtë nga
22 Prokuroria dhe nga ne, nuk është e qartë se mbi ç'bazë është
23 bërë një deklaratë kaq shumë e gjatë prej saj.

24 Sa i takon çështjeve që ajo kërkon që të komentojë mbi
25 disa fusha, neve themi që ajo nuk mund të japë prova në qoftë

1 se nuk ka qenë e pranishme dhe deklaratat e saj nuk duhet të
2 merren parasysh.

3 P.sh., e dimë që është bërë gjithashtu edhe një kërkesë
4 tjetër nga ZPS-ja për shtimin e një tjetër dëshmitari,
5 ndërkohë që ne do të japim parashtrimet tona më vonë gjatë
6 ditës së sotme në qoftë se ky dëshmitar duhet të thirret apo
7 jo.

8 Megjithatë, ka shqetësime shqetësuese, ka shqetësime të
9 mëdha, që pjesa më e madhe e parashtrimeve që kërkojnë që të
10 pranohen nga Prokuroria shkojnë përtej njohurive që kishte
11 dëshmitarja dhe për këtë arsye nuk duhet të pranohen nga Trupi
12 Gjykues.

13 Një ndër gjërat që ka shpjeguar në detaje z. Rees dhe me
14 të cilën ne jemi dakord, z. Rees, ka përcaktuar në hollësi
15 çështjen e vazhdimësisë dhe efektin e zinxhirit të provave.

16 Sa i takon fragmenteve të dokumenteve nga paketat më
17 duhet të them që zinxhiri i ruajtjes është një çështje e
18 rëndësishme.

19 Ndërkohë, z. Rees i është referuar mungesës së ndonjë
20 gjëje të përcaktuar nga znj. Pumper për të përcaktuar
21 vijimësinë ose zinxhirin e ruajtjes. Ne kemi përcaktuar dhe më
22 parë dhe do të doja ta theksoja dhe njëherë tani, se duke
23 marrë parasysh mungesën e listës, të sekuestrimit apo
24 kategorizimin e detajuar të hollësishëm lidhur me dokumentet
25 të cilët janë marrë, pra, ato jo në mënyrë të domosdoshme janë

1 prova për shkak të faktit që gjenden në njëren paketë ose në
2 tjetrën.

3 Ajo çfarë nuk kemi dëgjuar ne është që nuk kemi dëgjuar
4 prova për të konfirmuar që materiali është analizuar, është
5 shqyrtuar nga znj. Pumper dhe se ky material ka qenë i njëjti
6 material si materiali që është sekuestruar nga OVL e UÇK-së.
7 Sërish do të doja të thosha që zinxhiri i ruajtjes, pra,
8 mbetet një çështje shqetësuese.

9 Sa i takon dokumenteve të kategorisë 3, dokumentet P99
10 MFI. Sigurisht që kjo është një çështje e cila mund të
11 pranohet ose jo nga një dëshmitar tjetër shtesë që kërkon ZPS-
12 ja tashmë që të shtojë në listën e vet të dëshmitarëve. Znj.
13 Pumper nuk është autorja e këtij shënimi, e këtij njoftimi dhe
14 si rezultat nuk duhet të ketë të drejtë që të komentojë
15 përbërjen apo përmbajtjen e tij.

16 Në mënyrë që një provë materiale të pranohet individit
17 duhet të jetë autori i shënimit dhe duhet që të japë prova
18 lidhur me përmbajtjen e saj. Pra, siç e thashë pra, mbase mund
19 të kemi deklaratat të tjera nga zyrtarë të ZPS-së dhe ZPS-ja
20 nuk kërkon që të thërrasë.

21 Po ashtu Trupi Gjykues ka vendosur më përpara lidhur me
22 njoftimet, me shënimet e kontaktit. Dhe sërish përgjigja e
23 ZPS-së është që të thërrasë dëshmitarë të tjerë. Dhe,
24 gjithsesi, për arsye që i di vetëm ZPS-ja, pavarësisht kësaj
25 dhe pavarësisht rregullave të procedurës, ajo nuk i ka

1 respektuar këto rregulla deri tani.

2 Sa i takon kategorisë 4, që merret me Paketën 2. Do të
3 doja të thosha të njëjtën gjë lidhur me çështjet dhe problemet
4 e lidhura me zinxhirin e ruajtjes dhe me rëndësinë e tyre.

5 Sa i takon kategorisë 5, Paketës 3. Nuk do të shtoja
6 asgjë tjetër përveç asaj që tha z. Rees dhe jam plotësisht
7 dakord me atë që parashtroi ai lidhur me këtë aspekt.

8 Lidhur me kategorinë 6. Z. Rees, ka përshkruar testin e
9 rëndësisë se i cili nuk është përmbushur sa i takon këtij
10 dokumenti.

11 Dhe lidhur me kategorinë 7, ne, në fakt, dëgjuam që në
12 fakt këto janë dokumente që duhet që konsiderohen si të
13 njoftueshme në aspektin gjyqësor apo jo.

14 Lidhur me kategorinë 8, provat materiale të lidhura.
15 Përsëri, nuk e ndjej të nevojshme që të shkoj përtej asaj
16 çfarë u tha nga z. Rees.

17 Dhe, sigurisht, lidhur me kategorinë 9, që ka të bëjë me
18 dokumentet të cila i përmendi z. Rees. Juve dëgjuat pozicionin
19 e tij, kështu që, nuk besoj që ka ndonjë gjë tjetër për të
20 shtuar lidhur me këtë aspekt. Nuk kam asgjë tjetër për të
21 shtuar përveç asaj që tha z. Rees në deklaratën e tij.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim]

23 Faleminderit, z. Rees [sipas përkthimit].

24 Jemi pak herët, megjithatë do të bëjmë pushimin e
25 paradites përpara sesa të vijojmë me dëshminë e dëshmitarit të

1 radhës. Tani marrim pushim dhe do të kthehemi sërish në orën
2 11.30.

3 --- Pauza fillon në orën 10.50

4 --- Seanca rifillon në orën 11.30

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

6 Z. CADMAN: [Përkthim] Desha të ngre një çështje para
7 Trupit Gjykses përpara se të vijë me dëshmitarin po nuk lidhet
8 me vetë dëshmitarin. Sikurse e dini komunikimet midis palëve
9 në këtë çështje kanë qenë larg optimale. Pas një çështje që
10 ngrita para Trupit Gjykses në fillim të kësaj jave përveç atij
11 ekspertit që ia bëra të njohur ZPS-së dokumentet që ne duhet
12 t'ia paraqesim atij dëshmitari, pra ekspertit që ai t'i
13 shqyrtojë lidhen me pyetjen që i bëmë ZPS-së në lidhje me atë
14 nëse kishte kundërshtime për paraqitjen atyre dokumenteve.

15 Thjesht ZPS-ja na informoi se për momentin nuk do të
16 marrin kurrfarë qëndrimi dhe thjesht desha ta cek këtë për hir
17 të procesverbalit para Trupit Gjykses.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju

19 faleminderit z. Cadman.

20 Z. Pace.

21 Z. PACE: [Përkthim] Vetëm shkurtimisht të nderuar
22 Gjykatës. Është e saktë ajo që tha avokati për përgjigjen
23 tonë.

24 Ne do të kishim kundërshtuar të kishim pasur mundësinë,
25 që është më e rëndësishme eksperti nuk është një ekspert i

1 përbashkët i propozuar. Është një ekspert i Mbrojtjes. Prandaj
2 e çmuam këtë pavend në këtë fazë që të propozojmë materiale që
3 do t'i jepen atij eksperti.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
5 faleminderit.

6 Atëherë tani mund të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit
7 që është me radhë.

8 Znj. Sekretare sillni dëshmitarin.

9 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes
11 z. Jukiç.

12 Ndihmësi i sallës së gjyqit do t'ju japë tekstin e
13 deklaratës solemne që duhet ta bëni në përputhje me rregullin
14 141(2) të Rregullores. Ju lutem lexoni tekstin.

15 DËSHMITARI: [Përkthim] I ndërgjegjshëm për rëndësinë time
16 dhe përgjegjësinë time ligjore deklaroj solemnisht se do të
17 them të vërtetën, krejt të vërtetën, dhe vetëm të vërtetën dhe
18 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
20 z. Jukiç. Tani mund të uleni.

21 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit.

22 DËSHMITARI: MIRO JUKIÇ

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] z. Jukiç, sot
24 do të fillojmë me dëshminë tuaj që mund të zgjasë deri në tre
25 ditë. Sikurse e dini pala e parë që do ju bëjë pyetje është

1 Prokuroria, pastaj vijon Mbrojtja me pyetje që mund të ketë,
2 pyetje mund të kenë edhe anëtarë të Trupit të Gjykatës.

3 Prokuroria ka përllogaritur se do t'i duhen katër orë për
4 t'ju marrë në pyetje. Mbrojtja ka përllogaritur dy ditë.
5 Paneli do të lejojë pyetje plotësuese të Prokurorisë n.q.s.
6 plotësohen kushtet.

7 Ju lutem përgjigjuni në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të
8 qartë me fjali të shkurtra. N.q.s. nuk e kuptoni pyetjen
9 atëherë lirisht mund t'i kërkonit avokatit që ta përsërisë atë
10 ose mund të thoni lirisht që nuk e kuptoni dhe ai do t'ju
11 qartësojë pyetjen.

12 Ju lutem të flisni afër mikrofonit dhe prisni pesë
13 sekonda përpara se të filloni me përgjigjen. Flisni ngadalë në
14 mënyrë që përkthyesit të mund t'ju ndjekin.

15 Gjatë ditëve në vijim që do të jepni dëshminë në këtë
16 Gjykatë nuk lejoheni të diskutoni përmbajtjen e dëshmisë tuaj
17 me askënd. N.q.s. dikush jashtë kësaj Gjykate ju pyet, atëherë
18 duhet të na informoni menjëherë.

19 Z. Prokuror, mund të filloni.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Pyetje nga z. Pace:

22 Py. Mirëdita z. dëshmitar.

23 Pë. Mirëdita z. Prokuror.

24 Py. E njohim njëri-tjetrin por do t'ju bëj disa pyetje në
25 mënyrë që të verifikojmë identitetin tuaj.

Dëshmitari: Miro Jukiç (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 43

- 1 Py. Si quheni?
- 2 Pë. Miro Jukiç.
- 3 Py. Datëlindja?
- 4 Pë. 4 dhjetor 1971
- 5 Py. Kombësia?
- 6 Pë. Kroat.
- 7 Py. Niveli i arsimit?
- 8 Pë. Kam kryer fakultetin juridik.
- 9 Py. Ku punoni aktualisht?
- 10 Pë. Punon në Zyrën e Prokurorit të Specializuar.
- 11 Py. Sa kohë punoni në ZPS?
- 12 Pë. Që nga shtatori i vitit 2019.
- 13 Py. Çfarë posti mbani në kuadër të ZPS-së?
- 14 Pë. Jam udhëheqës i ekipit për sigurinë dhe trajtimin e
- 15 dëshmitarit pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
- 16 Py. Sa kohë jeni në këtë post?
- 17 Pë. Nga prilli i këtij viti.
- 18 Py. Dhe përpara se të merrnit këtë detyrë, çfarë roli kishit
- 19 brenda ZPS-së?
- 20 Pë. Kam qenë punonjës i sigurisë së dëshmitarëve në ZPS.
- 21 Py. A mund në pika të shkurtra të na i përshkruani detyrat
- 22 tuaja dhe përgjegjësitë në postin që mbani tani?
- 23 Pë. Po. Jam këshilltar i Zëvendësprokurorit të Specializuar
- 24 dhe kryesues i Njesisë për Sigurinë Operative dhe të
- 25 Dëshmitarëve dhe të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë e

1 dëshmitarëve, qofshin ato administrative apo operative, janë
2 brenda përgjegjësive të kësaj zyre.

3 Py. A mund të na flisni pak për detyrat që kishit si punonjës
4 i sigurisë së dëshmitarëve, post që keni mbajtur më përpara?

5 Pë. Si punonjës i sigurisë së dëshmitarëve ishim në kontakt
6 të drejtpërdrejtë me dëshmitarët, me të gjithë dëshmitarët për
7 të cilët është përgjegjës Zyra e Prokurorit të Specializuar.
8 Mbajmë kontakt me ta në lidhje me të gjitha nevojat dhe
9 takimet e Prokurorisë me dëshmitarët.

10 Py. Keni kontakte të drejtpërdrejta me dëshmitarët në rolin
11 që keni tani?

12 Pë. Po.

13 Py. Përpara se të fillonit punën me ZPS-në, a mund të na
14 thoni në pika të shkurtra se çfarë detyrash keni kryer?

15 Pë. Po. Gjatë 20 viteve të fundit kam punuar në fushën e
16 mbrojtjes së dëshmitarëve.

17 PËRKTHYESI: Përkthyesit kërkojnë që folësit të flasin më
18 ngadalë dhe të bëjnë pushim midis pyetjeve dhe përgjigjeve.

19 Z. PACE: [Përkthim] Më është thënë që të flas më ngadalë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do të
21 shtoj asnjë gjë se ishte mjaft e qartë kërkesa e përkthyesve.

22 DËSHMITARI: [Përkthim] Në rregull.

23 Z. PACE: [Përkthim]

24 Py. Z. dëshmitar ju pyeta n.q.s. përpara se të fillonit punën
25 me ZPS-në keni pasur një përvojë të ngjashme të punës me atë

1 që e kryeni tani në ZPS.

2 Pë. Gjatë 20 viteve të fundit të karrierës time, kam punuar

3 në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve në nivel ndërkombëtar

4 dhe kombëtar në zonën e Ballkanit, në Kroaci dhe në Bosnjë

5 përpara se të filloja punën me ZPS-në. Kam punuar 6 vjet me

6 Tribunalin Penal për ish-Jugosllavinë si oficer për mbrojtjen

7 e dëshmitarëve apo mbështetjen e dëshmitarëve dhe viktimave.

8 Py. Dhe mesa ju kuptova puna që keni kryer me këto organizata

9 të tjera është e ngjashme për nga natyra me atë që kryeni në

10 ZPS apo jo?

11 Pë. Po. Kam punuar gjithashtu edhe për Ministrinë e Punëve të

12 Brendshme të Kroacisë dhe kam punuar me Tribunalin Penal

13 Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.

14 Py. Detyrat dhe përgjegjësitë a janë të ngjashme me detyrat

15 që i kryeni në Zyrën e Prokurorit të Specializuar?

16 Pë. Po. Sidomos gjatë punës që kam bërë me TPNJ-në. Aty kam

17 punuar siç thashë si oficer i mbrojtjes. Isha i angazhuar në

18 punën që lidhej me viktimat, pra me mbështetjen e viktimave

19 dhe trajtimin e nevojave të tyre.

20 Py. A ju kujtohet që i keni dhënë një deklaratë ZPS-së në

21 tetor të vitit 2020 dhe më pas një shtojcë ndaj asaj deklarate

22 në janar të 2021?

23 Pë. Po.

24 Py. Do t'ju bëj disa pyetje të përgjithshme në lidhje me

25 deklaratën e tetorit 2020.

1 Së pari, a mund të na thoni në pika të shkurtra se për
2 çfarë bëhej fjalë në këtë deklaratë të tetorit 2020 në terma
3 të përgjithshme?

4 Pë. Përgjithësisht deklarata kishte lidhje me kontaktimet e
5 dëshmitarëve pas rrjedhjes së dokumenteve të ZPS-së në publik.

6 Py. Ju thatë që kjo deklaratë kishte të bënte me kontaktet që
7 kishit ju me dëshmitarët. A përfshihet në deklaratë
8 informacion lidhur me kontaktet që kanë pasur persona të tjerë
9 me dëshmitarët në kontekstin e njëjtë si ai i juaji?

10 Pë. Po. Kam pasur edhe disa shënime zyrtare që i kam
11 rishikuar, shqyrtuar, të kontakteve që kolegët, prokurorët
12 kanë pasur me dëshmitarët.

13 Py. Dhe në terma të përgjithshme lidhur me këto kontaktet që
14 ju vetë keni pasur dhe që janë raportuar në deklaratë, çfarë
15 mund të na thoni?

16 Pë. Pas rrjedhjes së informacionit dhe dokumenteve, kemi
17 marrë disa telefonata nga dëshmitarë, që shfaqën shqetësimet e
18 tyre që ishin të frikësuar në lidhje me faktin që emrat e tyre
19 ishin bërë në mediat në Kosovë dhe në rajon. Ne morëm vendim
20 që t'i thërrasim me telefon dhe t'i informojmë që emrat e tyre
21 ishin, kishin rrjedhur, ishin në dokumentet publike dhe se të
22 gjitha njohuritë e mia të përfshira në deklaratë, kanë të
23 bëjnë me kontaktet që kam pasur me ata njerëz.

24 Py. A ju kuptova drejtë se kjo deklaratë pasqyron
25 informacionin që keni marrë nga këto kontakte që i përshkruat?

1 Pë. Po.

2 Py. Ju përmendët shqetësimet dhe frikësimet që përmendën
3 dëshmitarët kur i kontaktuat. Dhe kur thoni se personat na
4 kontaktuan këto kontakte ishin me anë të telefonit?

5 Pë. Procedura e zakonshme e jonë është që pas intervistës me
6 një dëshmitar u japim atyre një numër telefoni të plotë në
7 rast se duan të vendosin kontakt me ZPS-në. Këto janë numra
8 telefoni të linjës për sigurinë e dëshmitarëve dhe kjo është
9 mënyra se si mund të na kontaktojnë dëshmitarët.

10 Py. Kur ky numër i telefonit i jepet dëshmitarëve a ju bëhet
11 e qartë se ky është numër i kontaktit në rast të çështjeve që
12 lidhen me sigurinë me sa e dini ju?

13 Pë. Është në lidhje me të gjitha çështjet që lidhen me ZPS-
14 në.

15 Py. Dhe ju përmendët që edhe dëshmitarët kontaktuan ZPS-në,
16 por edhe se ZPS-ja kontaktoi dëshmitarë. Si u bë kjo?

17 Pë. Pas rrjedhjes së informacionit më 22 shtator, ne morëm
18 vesh se cilat dokumente ishin bërë publike, vendosëm që ta
19 shikojmë listën, t'i shqyrtojmë dokumentet dhe t'i
20 identifikojmë të gjithë emrat e përfshirë në rrjedhjen e
21 informacionit. Pasi i identifikuam të gjithë ata emra, kaluam
22 listën një nga një, identifikuam të gjithë dëshmitarët
23 bashkëpunues dhe morëm vendim që t'i thërrasim me telefon dhe
24 t'i informojmë për rrjedhjen e informacionit. Në atë moment ne
25 kishim mendimin se kishim detyrimin që t'i informojmë

1 njerëzit, ata që kishin dhënë deklaratat dhe që kishin
2 bashkëpunuar me ZPS-në. Pra e kishim detyrimin t'i informojmë
3 ata se emrat e tyre ishin bërë publikë.

4 Py. Besoj që ju mendoj që thatë 22 dhjetor por e kishit një
5 datë tjetër ndërmend apo jo?

6 Pë. Po, shtatorin, më falni.

7 Py. Dhe kur thoni dokumente që u bënë publike, e keni fjalën
8 për bërjen publike të dokumenteve në pres konferencat e OVL-
9 UÇK-së?

10 Pë. Po.

11 Py. Ju thatë se mes personave, të cilët u kontaktuan kishte
12 viktima. A mund të na jepni më pak shpjegim në lidhje me këtë?

13 Pë. Ne i kemi ndarë dëshmitarët në disa kategori. Njëra prej
14 këtyre kategorive janë viktimat, të cilat për mendimin e ZPS-
15 së janë persona që janë keqtrajtuar, rrahur apo torturuar në
16 çfarëdo mënyre të mundshme nga dikush tjetër gjatë periudhës
17 që mbulon mandati jonë në Kosovë.

18 Py. Dhe kur përmendët konceptin e dëshmitarëve bashkëpunues a
19 mund të na shpjegoni se çfarë nënkuptoni me këtë koncept?

20 Pë. Kjo nënkupton çdo dëshmitar që është ftuar nga ZPS-ja dhe
21 që ka dhënë deklaratë, që i ka dhënë deklaratën ZPS-së.

22 Py. Dhe personat që i keni kontaktuar, i keni kontaktuar me
23 telefon apo në një mënyrë tjetër apo në të dyja mënyrat?

24 Pë. Pjesë më e madhe e tyre u kontaktuan me telefon. Disa
25 prej tyre insistuan që të takoheshin sy në sy dhe disa të

1 tjerë meqë nuk arritëm t'i kontaktonim me telefon, nuk ishin
2 në gjendje të vinim kontakt me ta, atyre ju shkuam në shtëpi
3 për t'i takuar.

4 Py. Në lidhje me kontaktet që keni pasur me telefon, a mund
5 të na thoni sesi i keni marrë ato numra telefoni?

6 Pë. Këto numra telefoni i kemi marrë nga burime publike në
7 Kosovë dhe prej vetë dëshmitarëve gjatë intervistave që kanë
8 pasur me ZPS-në. Ata vetë na i kanë dhënë numrat e telefonit.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më falni.

10 Z. Rees.

11 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës ju sot thatë se
12 do të jetë me rëndësi që Prokuroria të identifikojë çështjet
13 që janë brenda dijenisë së këtij dëshmitari, por këtë moment
14 nuk shoh një orvatje të tillë nga ana e Prokurorit. Thjesht po
15 i bëhet pyetje dëshmitarit "ti" ose "ju" dhe dëshmitari
16 përgjigjet me "ne". Nuk e kritikoj dëshmitarin që përgjigjet
17 këtu mirëpo do të ishte pak më e rrugës që të jemi më
18 specifikë dhe konkretë.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Duhet të jemi
20 të kujdesshëm me emrat, prandaj edhe duhet të përmendim disa
21 terma më të përgjithshme kur ju referohemi dëshmitarëve dhe
22 viktimave.

23 Z. REES: [Përkthim] Në këtë moment pyetjet që po bëhen
24 janë pyetjet të përgjithshme në lidhje me zyrën dhe me sa i
25 kuptova unë udhëzimet e juaja si Trup Gjykues, Prokuroria

1 duhet ta bëjë të qartë gjatë marrjes në pyetje të këtij
2 dëshmitari se çfarë veprimesh apo çështjesh janë brenda
3 dijenisë dhe veprimeve të këtij dëshmitari.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem që
5 t'i bëni më specifike pyetjet në mënyrë që të jemi të qartë se
6 çfarë pyetni.

7 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull i nderuar Gjykatës.
8 Py. Z. dëshmitar, ndoshta mund të na qartësoni, kur flisni
9 për shembull lidhur me personat identifikimin e emrave të
10 viktimave dhe të dëshmitarëve bashkëpunues ju vetë a morët
11 pjesë në procesin e identifikimit të këtyre personave apo kush
12 i kontaktoi ata?

13 Pë. Unë u përfshiva në atë proces në rolin e punonjësit të
14 sigurisë së dëshmitarëve. Kur them "ne", i referohem oficerëve
15 apo punonjësve të sigurisë së dëshmitarëve, sepse unë nuk jam
16 i vetmi person që punon në atë njësi.

17 Py. Dhe kur flisni për kontaktet me telefon, i keni bërë këto
18 kontakte ju vetë sikurse i përshkruat më herët?

19 Pë. Po.

20 Py. A ju kam kuptuar drejtë kur thoni se dëshmitari,
21 dëshmitarët ua kanë dhënë një farë numri telefoni ku mund t'i
22 thërrisni dhe këto numra telefoni i keni përdorur më vonë
23 gjatë vitit të kaluar?

24 Pë. Pas një interviste me një dëshmitar, oficerët e sigurisë
25 së dëshmitarëve bëjnë një farë lloj interviste me dëshmitarët,

1 marrin të gjithë informacionin e nevojshëm që lidhet me
2 sigurinë e dëshmitarit, adresën e shtëpisë, numrat e telefonit
3 si dhe numrat e telefonit të tjerë ndihmës, n.q.s. nuk mund
4 t'i gjejmë në numrin e tyre të telefonit.

5 Py. Dhe a janë këto numra të telefonit që ju dhe kolegët tuaj
6 i keni përdorur për t'i kontaktuar dëshmitarët pas bërjes
7 publike të dokumenteve në shtator të vitit të kaluar?

8 Pë. Po.

9 Py. Ju na thatë se ju jeni një nga personat që kanë bërë këto
10 kontakte. Nëse ju kujtohet a mund të na thoni përafërsisht se
11 sa telefonata të tilla janë bërë në lidhje me incidentet e
12 shtatorit 2020?

13 Pë. Rreth 30. Ndoshta jam takuar me 30 vetë.

14 Py. Ju thatë se edhe oficerë të tjerë të sigurisë së
15 dëshmitarëve u përfshinë në këtë aktivitet. A morën pjesë edhe
16 ata në kryerjen e telefonatave apo në takimet që patët me këta
17 persona?

18 Pë. Po, edhe ata morën pjesë.

19 Py. A përdorët përkthyes apo ndihmës gjyqësorë gjatë këtyre
20 kontakteve?

21 Pë. Kemi përdorur përkthyes gjatë çdo telefonate të bërë.

22 Py. Na thatë përafërsisht se sa telefonata dhe sa takime u
23 bënë përafërsisht në të cilët morët ju pjesë. A mund të na
24 thoni përafërsisht sesa telefonata u bënë përgjithësisht nga
25 stafi i ZPS-së?

1 Pë. Rreth dyqind telefonata.

2 Py. Po këto biseda telefonike me këta persona a u dokumentuan
3 në një farë mënyre?

4 Pë. U dokumentuan në nota apo shënime zyrtare, pas vetë
5 telefonatës.

6 Py. Dhe cili është qëllimi i këtyre notave zyrtare? Pse i
7 përpiluat ato?

8 Pë. Kjo është një pjesë e procedurës. Çdo kontakt me
9 dëshmitarin shënohet.

10 Py. Ju thoni "ne" kjo sigurisht që ju përfshin ju dhe dikë
11 tjetër. Kush janë këta të tjerët?

12 Pë. Kur them "ne" kam parasysh veten, kolegët e mi, avokatët,
13 hetuesit dhe kështu me radhë. Kështu që në zyrën tonë çdo
14 kontakt me dëshmitarët duhet të shënohet dhe të mbahet shënim.

15 Py. A e dini se për çfarë përdoren këto shënime?

16 Pë. Për shembull tani përdoren në këtë çështje.

17 Py. A ka ndonjë arsye tjetër sepse mbahen shënime të tilla?

18 Pë. Po, është shumë me rëndësi për ne t'i kemi të gjitha
19 kontaktet me dëshmitarët në përgatitjet e gjykimeve dhe në
20 përgatitjet për marrjen e vendimeve n.q.s. do t'i thërrasim
21 ata si dëshmitarë ose jo.

22 Py. Kush i rishikon këto shënime zyrtare?

23 Pë. Udhëheqësi i ekipit të sigurisë së dëshmitarëve dhe
24 Zëvendësprokurori i Specializuar.

25 Py. A ka pasur ndonjëherë diskutime me sa dini ju me

1 Zëvendësprokurorin e Specializuar dhe me personat përgjegjës
2 në lidhje me këtë?

3 Pë. Kemi pasur diskutime lidhur me shënimet sepse kishte
4 shumë njerëz që shfaqën frikën e tyre dhe shumë njerëz që u
5 ndjenë të kërcënuar pas publikimit të dokumenteve dhe emrave
6 të tyre. Pra u diskutua në terma të përgjithshme se çfarë do
7 të bënim, si do të vazhdonim dhe çfarë masash dhe veprimesh do
8 të ndërmerrem.

9 Py. Po gjatë këtyre veprimeve që i përshkruat në lidhje me
10 kontaktimin e personave dhe identifikimin e emrave të tyre në
11 dokumente, a e kishit paraparë një gjë të tillë apo e kishit
12 planifikuar një gjë të tillë?

13 Pë. Po e kishim një plan. Së pari pas rrjedhjes së
14 informacionit kishim plan që t'i thërrasim njerëzit. Filluam
15 me telefonatat më 24 shtator. U ndamë në disa grupe ne
16 punonjësit e sigurisë së dëshmitarëve. Zakonisht një grup
17 përbëhej prej një oficeri të sigurisë së dëshmitarëve, një
18 avokati, një hetuesi dhe një përkthyesi në një telefonatë. Pra
19 kishte të përfshirë të paktën tre persona në një telefonatë.

20 Py. Dhe kjo që e përshkruani tani, a ishte prioritet për
21 zyrën në atë kohë?

22 Pë. Po, ishte një çështje e prioritetit më të lartë për zyrën
23 në atë kohë.

24 Py. Dhe kur thoni e prioritetit më të lartë, a ishte kjo
25 vetëm për ekipin tuaj apo për të gjithë zyrën?

1 Pë. Ishte prioritet për të gjithë ne.

2 Py. A u përfshitë ju vetë në planifikimin apo organizimin e
3 këtij aktiviteti?

4 Pë. Jo, në atë kohë u përfshiva vetëm në telefonatat.

5 Py. Dhe kush e mbikëqyrte këtë aktivitet në atë kohë?

6 Pë. Udhëheqësi i atëhershëm i ekipit për sigurinë dhe
7 trajtimin e dëshmitarëve.

8 Py. Dhe kur ky veprim filloi në shtator të vitit të kaluar, a
9 ju kujtohet n.q.s. stafi i ZPS-së ishte në terren apo punonte
10 nga shtëpia?

11 Pë. Punonim kryesisht nga shtëpia.

12 Py. Dhe a ishin të detyruar disa persona që të vinin në zyrë
13 për ta bërë këtë punë?

14 Pë. Kishte disa persona që kishin një detyrim të tillë që të
15 vinin në zyrë për ta bërë këtë punë.

16 Py. Për sa i përket intensitetit, si do ta kishit përshkruar
17 këtë veprim? Sa intensiv ishte ai?

18 Pë. Unë personalisht isha i përfshirë gjatë gjithë kohës në
19 këtë veprim. A kishit kohë që të bënit ndonjë punë tjetër
20 përveç kësaj pune?

21 Pë. Jo.

22 Py. Po të tjerët, kolegët tuaj, punonjës të sigurisë së
23 dëshmitarëve a kishin të njëjtin problem? Pra, ua merrte dhe
24 kjo gjithë kohën e punës?

25 Pë. Po, kjo veprimtari ua merrte pjesën më të madhe të kohës

1 së punës, jo vetëm oficerëve të sigurisë së dëshmitarëve por
2 edhe hetuesve dhe avokatëve.

3 Py. A mund të na thoni sesi emrat e personave të cilët i
4 kontaktoi ZPS-ja në kuadër të këtij veprimi, u trajtuan nga
5 ZPS-ja për sa i përket konfidencialitetit?

6 Pë. Për zyrën tonë të mbrojtjes së dëshmitarëve kjo është një
7 prioritet më i lartë. Ne e dimë nga përvoja se pa dëshmitarë
8 nuk mund të kesh një çështje gjyqësore dhe për ne, emrat e
9 dëshmitarëve janë të prioritetit më të lartë. Pra kur them për
10 ne, për mua, e kam fjalën për oficerët e sigurisë së
11 dëshmitarëve.

12 Py. Për shembull, a i keni kontaktuar ndonjëherë këta persona
13 në një formë të pasigurt të thuash të komunikimit, mjet të
14 pasigurt të komunikimit?

15 Pë. Çdo herë i kemi kontaktuar nëpërmjet një forme të sigurt
16 të komunikimit.

17 Py. Ju është thënë të kontaktoni këtë apo atë person. Këta
18 emra dhe informacione të kontaktit të këtyre personave, a ju
19 dhënë në mënyrë të sigurt?

20 Pë. Po, të gjithë emrat na janë dhënë në mënyrë të sigurt.

21 Py. Në terma të përgjithshme a mund të na thoni sesa kanë
22 zgjatur këto kontakte?

23 Pë. Varet. Nuk e di n.q.s. jeni duke pyetur për çdo
24 telefonatë veç e veç apo për të gjithë procesin?

25 Py. Ju pyes në terma të përgjithshme, për shembull një

1 telefonatë zgjaste të themi disa minuta, më gjatë apo si?

2 Pë. Varej. Çdo telefonatë ka zgjatur të paktën 15 minuta.

3 Py. Në terma të përgjithshme dhe përsëri do të fokusohemi në
4 kontaktet që keni pasur ju drejtpërdrejtë dhe ku jeni
5 përfshirë ju në mënyrë të drejtpërdrejtë. Cili ishte reagimi i
6 personave që kontaktonit?

7 Pë. Të gjithë personat ishin shumë të shqetësuar. Disa prej
8 tyre fillonin të bërtisnin në telefon. Disa na thonin që të
9 mos t'i kontaktonim më dhe reagimi i tyre kryesisht nuk ishte
10 i mirë.

11 Py. Dhe këto reagime që i përshkruat çfarë i detyroi
12 dëshmitarët sipas jush që të reagonin në atë mënyrë?

13 Z. REES: [Përkthim] Dëshmitari nuk mund të përgjigjet në
14 këtë pyetje sepse është vetëm supozim.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
16 kundërshtimi.

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 Py. Ju thatë që dëshmitarët që ndjeheshin të shqetësuar dhe
19 bërtisnin në telefon. A ju kujtohet se çfarë informacioni që u
20 ishte dhënë i detyroi ata, i bëri ata që të reagonin në atë
21 mënyrë?

22 Pë. Ne kur i kontaktonim prezantoheshim se kush ishim, pastaj
23 i pyesnim nëse kishin dëgjuar për rrjedhjen e informacionit
24 dhe dokumenteve të ZPS-së dhe i informonim ata n.q.s. emrat e
25 tyre ishin bërë publikë. Dhe n.q.s. po atëherë fillonin të

1 ndjeheshin shumë keq.

2 Py. Pra ata shprehën shqetësimet e tyre lidhur me
3 informacionin që ju dhatë?

4 Pë. N.q.s. e keni fjalën për njerëzit që i kemi marrë me
5 telefon, po.

6 Py. Po ata që ju morën juve në telefon?

7 Pë. Ata i shprehnin këto shqetësime menjëherë pas
8 telefonatës. Ishin mjaft të mërziur dhe të zemëruar.

9 Z. REES: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, edhe njëherë
10 duhet ta bëjmë të qartë n.q.s. dëshmitarit i bëhet pyetje për
11 kontaktet që ai ka pasur me dëshmitarët apo n.q.s. i bëjmë
12 pyetje në përgjithësi për rastet ku ka qenë dikush tjetër i
13 përfshirë?

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
15 kundërshtimi.

16 Ju lutem ta qartësoni këtë i nderuar Prokuror.

17 Z. PACE: [Përkthim]

18 Py. Z. dëshmitar, tani të fillojmë me kontaktet që personat i
19 kanë pasur me ju.

20 Së pari, a i keni marrë këto telefonata ju vetë?

21 Pë. Unë kam marrë telefonata përpara se të vendosnim të
22 thërrasim vetë dhe të informonim të gjithë dëshmitarët.

23 Py. Në terma të përgjithshme, a ju kujtohet se çfarë ju kanë
24 thënë këta persona gjatë bisedave?

25 Pë. Më kujtohet një rast ku njëri na tha që këtë besim te ne

1 dhe si mundet që emri i tij të ketë dalë në publik dhe se
2 familja e tij ishte e rrezikuar dhe më tha "E di shumë mirë se
3 çfarë ka ndodhë me dëshmitarët në Kosovë".

4 Py. Për të qenë të qartë, ky ishte një kontakt me një person
5 përpara fillimit të aktivitetit që e përshkruat më lart?

6 Pë. Po ishte një kontakt përpara atij aktiviteti.

7 Py. A keni ndonjë dijeni për sa i përket kolegëve tuaj nga
8 ZPS-ja që kanë marrë thirrje të ngjashme apo informacione të
9 ngjashme?

10 Pë. Edhe kolegët e mirë kanë marrë mesazhe të ngjashme nga
11 telefonatat.

12 Py. Dhe si e dini këtë?

13 Pë. Sepse kishim takime të përditshme si ekip i sigurisë së
14 dëshmitarëve. Dhe kolegët e mi kishin takime të përditshme me
15 dëshmitarët dhe me udhëheqësin e ekipit të sigurisë dhe
16 trajtimit të dëshmitarëve.

17 Py. A mund të na thoni se çfarë diskutoni konkretisht?

18 Z. REES: [Përkthim] Ne e kemi diskutuar këtë çështje dhe
19 ju si Trup Gjykues keni dhënë vendim. Mesa kuptova unë ju i
20 keni kufizuar pyetjet e këtij dëshmitari bazuar në çështje të
21 cilat ai i di drejtpërdrejt dhe jo nga ato që i kanë thënë
22 atij të tjerët.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E pyetën për
24 takimet që kanë mbajtur. Nuk jam i sigurt ende se ku do të
25 dalë. E kuptoj kundërshtimin tuaj. Do ta lë të vazhdojë dhe do

1 të jap vendim nëse është e nevojshme më vonë.

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 Py. Z. dëshmitar, takimet për të cilat po flisni me
4 punonjësit e sigurisë së dëshmitarëve, keni qenë i pranishëm
5 ju?

6 Pë. Në fakt ishin takime me telefon.

7 Py. A keni marrë pjesë në to.

8 Pë. Po.

9 Py. E keni dëgjuar informacionin që jepnin kolegët?

10 Pë. Po.

11 Py. Ju keni dhënë gjithashtu kontributet tuaja në diskutime
12 gjatë këtyre takimeve?

13 Pë. Po.

14 Py. Çfarë informacioni keni shkëmbyer me kolegët në takime të
15 tjera në përgjithësi?

16 Pë. I gjithë informacioni që mora nga dëshmitarët gjatë
17 telefonatave apo shkëmbimeve të mesazheve ua bëja atyre të
18 njohur.

19 Py. Kolegët bënë të njëjtën gjë?

20 Pë. Po.

21 Py. Ju thatë që personat e kontaktuar ishin të shqetësuar dhe
22 bërtisnin në telefon. A mbani mend nga kontaktet që ju jeni
23 përfshirë të gjithë personat u thanë që ishin të trembur, apo
24 kishte dhe nga ata që nuk ju thanë se ishin të trembur, të
25 frikësuar?

1 Pë. Të gjithë personat që më kontaktuan mua ishin të
2 shqetësuar dhe të tronditur.

3 Py. Nga informacioni që ju kanë dhënë kolegët po ashtu të
4 gjithë ishin të shqetësuar, apo kishte ndonjë që nuk ishte i
5 trembur dhe i frikësuar?

6 Pë. Të gjithë personat që na kontaktuan ne ishin të trembur,
7 por disa nga ata që ne i kontaktuam më vonë gjatë ushtrimit
8 tonë thanë që nuk duan t'ia dinë dhe nuk kanë frikë.

9 Py. A mund të na thoni që si pasojë e atyre që ju thanë ju
10 dhe kolegëve, nëse ZPS-së iu desh të merrte hapa konkretë apo
11 masa konkrete lidhur me sigurinë e tyre?

12 Pë. ZPS-ja ndërmoi shumë hapa, mori shumë masa pas kësaj
13 gjëje.

14 Py. A mund të na thoni në përgjithësi për çfarë e keni fjalën
15 kur thoni shumë masa dhe hapa?

16 Pë. Disave prej tyre u dhamë numra të reja telefoni dhe
17 pajisje telefonike për komunikim të sigurt me ne. Përgatitëm
18 për shumë prej tyre plane për menaxhimin e riskut. Gjithashtu
19 i zhvendosëm disa prej tyre nga Kosova.

20 Py. Të fillojmë me dhënien e aparateve të reja telefonike.
21 Besoj që e kam kuptuar drejtë që thatë që iu dhanë aparate
22 telefonike të reja?

23 Pë. Në rastin e disa dëshmitarëve të cilët nuk kishin mundësi
24 të na kontaktonin siguruam bisedë, -- ju dhamë internet për
25 kontakt të sigurt, ju dhamë aparate për kontakt të sigurt.

1 Py. Për të qenë të sigurt, pra kjo erdhi si pasojë e asaj që
2 ndodhi në shtator?

3 Pë. Po.

4 Py. Ju përmendët se përgatitët plane emergjente për
5 menaxhimin e riskut, a mund të na thoni se ç'është një plan i
6 tillë?

7 Pë. Një plan emergjent i menaxhimit të riskut është një plan
8 që përgatitet në raste emergjente sipas të cilit mund t'i
9 marrim dëshmitarët dhe familjet e tyre nga shtëpitë e tyre dhe
10 i vendosim në zyrën tonë.

11 Py. A mund të na thoni sesi bëhet një plan i tillë? Kush e
12 bën? Ju apo shumë persona?

13 Pë. U përfshinë shumë persona, përfshirë punonjësit e
14 mbrojtjes së dëshmitarëve dhe të zyrtarëve të sigurisë
15 operacionale.

16 Py. Ju përmendët gjithashtu dhe zhvendosjen e tyre. A mund të
17 na thoni në përgjithësi pa e specifikuar se me kë kishte të
18 bënte zhvendosja?

19 Pë. Zhvendosja e personave ishte lidhur me personat që ishin
20 të frikësuar dhe që nuk donin të rrinin më në vendin e tyre,
21 në shtëpitë e tyre.

22 Py. Si u mor vendimi për zhvendosjen e dëshmitarëve? Çfarë
23 faktesh u morën parasysh kur ju morët vendim të tillë?

24 Pë. Ishin dy faktorë, kërcënimi dhe deklaratat, rëndësia e
25 deklaratës së dëshmitarit.

Dëshmitari: Miro Jukiç (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 62

1 Py. Ju personalisht a ishit i përfshirë në vendimin e marrjes
2 së vendimit për zhvendosjen e dëshmitarëve të lidhur me
3 ngjarjen, me dokumentet që u bënë publik në shtator?

4 Pë. Po.

5 Py. Dhe ju përmendët dy faktorë që ishin kërcënimi dhe
6 rëndësia e deklaratës. Kur flisni për kërcënimin, e keni
7 fjalën për kërcënimin në kuptimin e përgjithshëm apo atë që ju
8 komunikua ju në telefonata?

9 Pë. Në këtë rast ishte kërcënim lidhur me nxjerrjen e
10 dokumenteve dhe bërjen publike të emrave të tyre.

11 Z. PACE: [Përkthim] Përkthyesi ankohet se flet shpejt. I
12 kërkoj ndjesë.

13 Do të kërkoj që t'i tregohet dëshmitarit një dokument. Në
14 këtë fazë pra dua që të sjellë dosjen me materialet dhe t'i
15 tregohet dhe Mbrojtjes për inspektim për këqyrje. Ndërkohë që
16 bëhet kjo, ju lutem shfaqni në ekran dokumentin me numër
17 084303 deri në 084303RED. Faleminderit. E shoh që dokumenti
18 është në ekran.

19 Py. Z. dëshmitar, në këtë dosje keni nënndarje të verdha me
20 numra. Dua që të shikoni nënndarjen 190 dhe sipas udhëzimeve
21 tuaja.

22 Z. PACE: [Përkthim] Kjo tregon që është dokumenti 109 në
23 listën e provave të Prokurorisë [sipas përkthimit].

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

25 Z. PACE: [Përkthim]

1 Py. Z. dëshmitar, e shikoni këtë dokument?

2 Pë. Po.

3 Py. E njihni këtë dokument?

4 Pë. Po, e njoh.

5 Py. E njihni nënshkrimin tuaj aty?

6 Pë. Po, e njoh nënshkrimin tim.

7 Py. Shohim gjithashtu dhe emblemen e ZPS-së dhe fjalën "Notë
8 Zyrtare" aty në krye të dokumentit dhe poshtë atyre kemi një
9 tabelë me informacion ku jepet data, autori dhe aktiviteti.
10 Dhe pastaj ka disa fjalë.

11 Na thoni është standard formati i notave të tilla që
12 përdor ZPS-ja?

13 Pë. Po. Po është formati standard i Notave Zyrtare.

14 Py. Shohim që ka dhe dy data të ndryshme, ka një datë në
15 fillim dhe një datë tjetër në tekst. Mos e përmendni datën,
16 por vetëm na shpjegon pse janë data të ndryshme, ç'tregojnë
17 ato?

18 Py. Është data kur bisedova me dëshmitarin kur kam qenë në
19 Kosovë dhe data në fillim të dokumentit është data kur isha në
20 zyrë dhe e kam futur këtë dokument në ZyLAB.

21 Py. Ju thatë që data në tekst tregon datën që keni qenë në
22 Kosovë. Duhet të kuptoj që është data kur kanë ndodhur
23 ngjarjet e regjistruara?

24 Pë. Është data kur kam thirrur dëshmitarin.

25 Py. A keni shqyrtuar ndonjëherë nota të ngjashme me këto të

1 bëra nga kolegët e tjerë?

2 Pë. Po.

3 Py. Në kuadër të ushtrimit që folëm më parë, pra bërjes
4 publike të dokumenteve, këto nota i bënin dhe kolegët tuaj
5 gjatë kësaj kohe në këtë ushtrim?

6 Pë. Po, prodhonin të njëjta apo të ngjashme.

7 Py. Do të flasim për një çast për përmbajtjen e kësaj note në
8 rreshtat e dytë dhe të tretë, poshtë aty. Poshtë tabelës bëhet
9 fjalë për një person, që identiteti i të cilit është redaktuar
10 nëse ka pasur ndonjë shqetësim lidhur me ngjarjet e fundit, me
11 publikimin e dokumenteve që gjoja vinte nga zyra e ZPS-së.
12 Është kjo një nga pyetjet që u bënit?

13 Pë. Është një nga pyetjet e zakonshme që u bënim gjatë
14 kontakteve.

15 Py. Për kë e keni fjalën kur thoni "ne" në shumës?

16 Pë. E kam fjalën për vete, për punonjësit e sigurisë së
17 dëshmitarëve, prokurorëve dhe hetuesve që i bënin këto
18 telefonata gjatë kësaj kohe.

19 Py. Përpara këtij ushtrimi, kishit ndonjë komunikim midis
20 jush apo kolegëve lidhur me si të drejtoheshit këtyre
21 kontakteve, çfarë pyetje tu bënit, çfarë informacione tu
22 jepnin?

23 Pë. Po, kemi diskutuar me kolegët, po kemi marrë dhe udhëzime
24 nga udhëheqësit e ekipeve të dëshmitarëve dhe të sigurisë së
25 dëshmitarëve se çfarë pyetjesh duhet tu bënim, çfarë

1 informacioni tuaj jepnim gjatë telefonatave.

2 Py. Këto nota, dhe e kam fjalën për rreshtin 4 deri në 8, në
3 tekst thonë që pasi e pyesni një person për shqetësimet e
4 sigurisë lidhur me incidentin e ndodhur, personi për shembull
5 ju ka thënë që nuk ndihet i sigurt se flitej në lagjen e tij
6 se ishte dëshmitar i ZPS-së dhe kjo e bënte të mos ndihej i
7 sigurt.

8 Mbani mend se ju kanë dhënë informacione të tilla qoftë
9 gjatë këtij kontakti konkret apo gjatë kontakteve të tjera që
10 keni bërë në atë kohë?

11 Pë. Po.

12 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në këtë moment
13 dëshiroj të pranohet kjo Notë Zyrtare.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
15 kundërshtim për këtë?

16 Z. REES: [Përkthim] A mund ta shtyjme pranueshmërinë
17 mbasi ne t'i bëjmë pyetje?

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pse?

19 Z. REES: [Përkthim] Jam mjaft i vetëdijshëm për rregullin
20 që dhatë sot për nxjerrjen e materialit. Jam shumë i
21 vetëdijshëm gjithashtu për faktin që ju e bëtë të qartë se
22 nëse gjatë pyetjeve kryesore dilnin çështje, të cilat mund të
23 shpinin në një kërkesë më konkrete për nxjerrje, atëherë ne
24 mund të bëjmë atë kërkesë.

25 Në rrethanat ku jemi dëshiroj që vendimi për

1 pranueshmërinë të shtyhet. Mbase mund ta bëni në një moment të
2 caktuar. Mbase në një moment të caktuar ne mund ta bëjmë të
3 qartë se nuk kemi kundërshtim nëse do të ndodhë kështu. Po a
4 mund t'ju kërkoj që në këtë fazë ta shënoni me MFI, pra
5 dokumenti i shënuar për identifikim.

6 Z. PACE: [Përkthim] A mund të flas dhe unë? Ne nuk shohim
7 arsye për ta shtyrë pranimin. Informacioni i është dhënë
8 lidhur me autenticitetin. Dëshmitari thotë që e mban mend, e
9 njeh edhe praninë. Shtyrja e pranimin të dokumenteve kur s'ka
10 arsye nuk ka të bëjë, -- nuk çon në efikasitetin e
11 procedurave.

12 Thjesht do të ishte ideale që të shmangim situata të
13 tilla. Çdo informacion sigurisht i nxjerrë nga pyetjet
14 kryesore apo gjithçka tjetër që mund të thotë dëshmitari, do
15 të shkojë tek pesha që ju do t'i vendosni pranueshmërisë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
17 z. Pace.

18 Z. Cadman dëshironi të shtoni ju gjë?

19 Z. CADMAN: [Përkthim] Jo, faleminderit. Jo më shumë se
20 ato që tha z. Rees. Ky është qëndrimi ynë.

21 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka
23 kundërshtim. Pra prova materiale është ajo që duhet dhe çdo
24 deklaratë që bëhet sigurisht lidhet me peshën e provave
25 materiale. Pra prova do të pranohet.

Dëshmitari: Miro Jukiç (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 67

1 Vendosini një numër ju lutem.

2 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë numrin P130.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
4 P130.

5 Vazhdoni z. Pace.

6 Z. PACE: [Përkthim]

7 Py. Dëshiroj që t'ju tregoj një dokument tjetër. Është
8 dokumenti me numër 093886 deri në 093387RED dhe është në
9 nënndarjen 354 të dosjes që keni përpara. E shikoni dokumentin
10 z. dëshmitar?

11 Pë. Po, e shoh.

12 Py. E njihni.

13 Pë. Po, e njoh.

14 Py. Pra kjo notë në paragrafin 4 thotë se jeni informuar që
15 një person, emri i të cilit është redaktuar dëgjoi për
16 nxjerrjen e dokumenteve një ditë më parë, dhe kjo gjë e kishte
17 bërë të shqetësuar të panikohej për sigurinë e vet dhe të
18 familjes së tij. Gjithashtu nota raporton se personi ju ka
19 thënë se ka marrë gruan dhe shohim një referencë që ka shkuar
20 në shtëpi me makinë dhe se është larguar nga Kosova sepse
21 kishte frikë të shkonte në punë. Në paragrafin 6, thotë se
22 keni marrë një mesazh nga ky person, ku thuhet se dokumentet e
23 nxjerra janë botuar në të gjithë median shqiptare. A e mbani
24 mend se ju ka dhënë një informacion të tillë siç paraqet kjo
25 notë?

1 Pë. Po.

2 Py. Gjatë ndërveprimeve që keni pasur ju, si kjo që po themi
3 apo gjatë telefonatave të tjera apo që në kontekstin e
4 ushtrimit që u tha më përpara, a krijuat përshtypjen nga
5 personat që kontaktonin se kishin dijeni lidhur me atë që kish
6 ndodhur me dokumentet në shtator të vitit 2020?

7 Pë. Ky person konkret që përmendët këtu, ishte shumë i
8 trembur që nga momenti i parë që u bë publik dokumenti nga OVL
9 UÇK-ja.

10 Py. Më herët na thatë se disa persona u kontaktonin vetë juve
11 dhe se këta persona kishin dijeni për dokumentet. Dua të
12 përqendrohem i se kur ju i keni kontaktuar fillimisht,
13 informacione që ju keni dhënë atyre, që ishte bërë publike për
14 ta, nuk e dinin pra apo e kishin dëgjuar përpara nga mjete të
15 tjera?

16 Pë. Ky ushtrim filloi vetëm me njerëzit që u telefononim ne,
17 ata, emrat e të cilëve gjendeshin në dokumente.

18 Py. Pra këta persona që i kishin emrat në dokumente, kur ju i
19 telefononit, ju kuptuat se e dinin që e kishin emrin, se këto
20 dokumente ekzistonin, apo ishit ju personi që i njoftuat ata
21 për këtë ngjarje?

22 Pë. Disa prej tyre e dinin për dokumentin. Disa e dinin se
23 emrat e tyre ishin aty, por shumica e tyre nuk e dinin se
24 emrat e tyre gjendeshin aty. Shumica e tyre e kishin dëgjuar
25 për rrjedhjen apo publikimin e këtyre dokumenteve.

1 Py. Në përgjithësi, shumica që kishin dëgjuar, e mësuar sesi
2 e kishin mësuar, nga e kishin mësuar nga persona të tjerë apo
3 mjete të tjera?

4 Pë. Gjatë këtyre telefonatave mësova se ata e kishin mësuar
5 nga media sepse ishte botuar në të gjithë mediat e Kosovës dhe
6 në rajon. Disa prej tyre që e mësuan që ishin emrat e tyre aty
7 dëgjuan, mësuan nga anëtarë të familjes apo nga miqtë se emrat
8 e tyre ishin bërë publikë në media.

9 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin
10 e kësaj note.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [E padëgjueshme].

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë
13 kundërshtim?

14 Z. REES: [Përkthim] Në lidhje me këtë sigurisht që
15 dokumenti paraqitet jo si e vërtetë e deklaratës së bërë nga
16 pala e tretë, emri i të cilit është redaktuar. Nëse është
17 kështu, nëse kam të drejtë, nuk kam kundërshtim.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [E padëgjueshme].

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Ne e dimë po tani
20 situata ka ndryshuar. Këto nota janë përgatitur nga
21 dëshmitari. Dëshmitari është këtu i pranishëm për të shpjeguar
22 përmbajtjen e tyre, çfarë ka ndodhur, procesin si më në
23 përgjithësi ashtu dhe më konkretisht. Keni marrë informacion
24 se kush është kontaktuar, si janë kontaktuar. Për këto arsye
25 pra kërkojmë pranimin për të vërtetën e përmbajtjes së kësaj

1 note.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [E padëgjueshme]

3 Po sigurisht që po e ofroj dokumentin. E paraqesim për të
4 vërtetën e kësaj çështjeje dhe ne e kuptojmë dhe do t'i japim
5 peshën që meriton për mendimin tonë në këto rrethana. Por ky
6 burrë është këtu dhe nuk ka ndonjë ndalim. Bëhet fjalë për
7 fjalët që dëgjohet, që dëgjohet nga të tjerët.

8 Kur diskutojmë ne bëhet fjalë -- kur personi që e ka
9 nënshkruar një deklaratë të tillë apo një notë të tillë, nuk
10 është personi që vjen ne Gjykatë të deponojë, të dëshmojë. Unë
11 e kuptoj kundërshtimin tuaj por informacioni do t'i japim siç
12 thashë peshën që duhet të ketë gjatë diskutimeve, debateve
13 tona të brendshme. Pra paraqitet për të vërtetën e kësaj
14 çështjeje. Dhe ju e paraqitët kundërshtimin tuaj z. Rees.

15 Z. REES: [Përkthim] Po, e paraqita.

16 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të jetë prova me
17 numrin P131.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace çdo
19 dokument duhet të jepni dhe mendimin tuaj për klasifikimin.
20 Pra atë përpara dhe për këtë ju lutem.

21 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë. Klasifikimi duhet
22 të vazhdojë të mbetet konfidencial. Kur të marr, kërkoj
23 informacion në seancë të hapur do të shprehem edhe për
24 konfidencialitetin e tyre. Megjithatë pjesa tjetër e
25 dokumentit, për shembull data dhe detaje të tjera do të thotë

1 që ky dokument do të publikohet ne uebsajtin tonë. Për këto
2 arsye neve i paraqitëm arsyet tona kur kërkuam të paraqiten.

3 Ne tani po kërkojmë informacion që besojmë se mund të
4 bëhet publik. Kurse pjesa tjetër e dokumentit nuk duhet të
5 bëhet publike, duhet të mbetet konfidenciale.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë po e
7 marr, po e pranoj këtë klasifikim sipas këshillës tuaj.

8 Z. PACE: [Përkthim] Dua që të shfaqim dokumentin 084008
9 deri në 084010 dhe është nënndarja 180 në dosjen tuaj.

10 Py. Z. dëshmitar, e njihni këtë dokument?

11 Pë. Po, e njoh.

12 Py. A mund të na thoni se çfarë është ky dokument?

13 Pë. Ju kërkoj ndjesë, a mund ta përsërisni numrin?

14 Py. Numri i nënndarjes është 180.

15 Pë. Po, është deklarata ime, deklarata ime e parë.

16 Py. Në faqen e fundit të këtij dokumenti 084010 është
17 nënshkrimi juaj aty që shohim apo jo?

18 Pë. Po, është nënshkrimi im.

19 Py. Dua që punonjësja e Gjykatës dhe dëshmitari të kalojmë
20 tek faqja e parë me numër 084008 dhe do t'i referohem
21 paragrafit 6 që fillon në këtë faqe dhe vazhdon në faqen
22 tjetër.

23 Py. Paragrafi 6 lexon kështu:

24 "Dhjetëra dëshmitarë me të cilët ZPS-ja ishte në kontakt
25 pasi dokumentet konfidenciale u bënë publike nga OVL UÇK-ja,

1 vunë në dukje se ndiheshin të shqetësuar, të stresuar, të
2 pasigurt, të kërcënuar dhe/ose të trembur mbas këtyre
3 publikimeve".

4 Është e saktë kjo z. dëshmitar nga ato që mbani mend
5 mbështetur në kontaktet që keni pasur edhe nga kontakte të
6 tjera që kishit dijeni në atë kohë?

7 Pë. Është e saktë dhe kjo është shkruar nga unë.

8 Py. Paragrafi vazhdon:

9 "Dhe këto janë disa shembuj jo shterues të informacionit
10 të dhënë nga disa prej këtyre dëshmitarëve gjatë kontaktit të
11 tyre me ZPS-në".

12 Përpara sesa të shkojmë tek ndonjëri prej këtyre
13 shembujve që jep deklaratën tuaj, a mund të na thoni se ku
14 keni bazuar ju këto shembuj që i keni përfshirë në deklaratë?

15 Pë. I kam bazuar në kontaktin që kam pasur me dëshmitarët.

16 Py. Mbani mend se ishin kontakte që i keni kryer vetë apo dhe
17 kontakte të tjera të kryer nga persona të tjerë, po për të
18 cilët ju kishit dijeni?

19 Pë. Shumica janë nga kontaktet e mia, por disa syresh sepse
20 unë kam parë dhe shqyrtuar dhe nota të tjerë të kolegëve,
21 ishin nga të kolegëve.

22 Z. REES: [Përkthim] A nuk duhet të përqendrohet
23 dëshmitari tek personat me të cilët ai vetë ka folur?

24 Z. PACE: [Përkthim] Po, n.q.s. më lejoni do ta bëj këtë
25 dhe kundërshtimi mund të merret më vonë, jo për t'i dalë

1 përpara por të mbaroj unë njëherë.

2 Z. PACE: [Përkthim] Do të kalojmë te paragrafi 7 i
3 deklaratës që është në faqen 084009. Dhe këtu shohim:

4 Z. REES: [Përkthim] Dëshmitarit do t'ia bëjë pyetjet
5 Prokurori sepse në parashtrimin duket leximi i deklaratës nuk
6 ka të bëjë me pyetjet që bëhen kryesore, pyetjet e
7 drejtpërdrejta?

8 Z. PACE: [Përkthim] N.q.s. më lejoni të shkoj te pyetja,
9 pastaj do të bëhet i qartë objekti i pyetjeve të mia. Pasi të
10 bëj një pyetje të tillë nëse ka kundërshtim atëherë mund të
11 bëhet në atë kohë.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta lejoj
13 të mbaroj pyetjen përpara se ju të kundërshtoni.

14 Z. PACE: [Përkthim]
15 Py. Paragrafi 7 i deklaratës lexon kështu:

16 "Një prej dëshmitarëve tha se pasi kish mësuar për
17 publikimin e informacionit konfidencial, u ndje i frikësuar
18 dhe i shqetësuar për sigurinë e tij, kështu që doli, iku nga
19 shtëpia në fillim dhe pastaj u largua nga Kosova".

20 Tani, përpara se t'ju bëj pyetjet dua t'ju tregoj dhe një
21 dokument tjetër përbri kësaj deklarate dhe është dokumenti që
22 pamë para pak çastesh që ka numrin 093386 deri në 093887RED,
23 nënndarja 354 në dosjen tuaj.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka numër në
25 prova materiale kjo?

1 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Po, për procesverbalin
2 ky është dokumenti P131.

3 Ju lutem referojuni këtij dokumenti me numër prova materiale.

4 Z. PACE: [Përkthim] Po, të nderuar. Atëherë po shikojmë
5 deklaratën dhe provën materiale P131.

6 Py. Z. dëshmitar, n.q.s. e kujtoni informacionin që lexuam në
7 notën që iu referuam pak më përpara dhe paragrafi që sapo
8 lexova në deklaratën tuaj, a e mbani mend n.q.s. informacioni
9 i dhënë në paragrafin 7 të deklaratës tuaj mbështetet tek nota
10 që përmendëm pak më përpara, dokumenti pra P131?

11 Pë. Informacioni në paragrafin 7 mbështetet në këtë Notë
12 Zyrtare.

13 Z. PACE: [Përkthim] Dua t'i tregoj një tjetër dokument
14 dëshmitarit. Është dokumenti 089886 deri në 089886RED, ndarja
15 228.

16 Py. Z. dëshmitar, a e keni parë këtë dokument më parë?

17 Pë. Po.

18 Py. A është nënshkrimi juaj nënshkrimi në fund të këtij
19 dokumenti?

20 Pë. Po, ky është nënshkrimi im në fund të dokumentit.

21 Py. Në përgjithësi, a e mbani mend diskutimin që mbulohet nga
22 kjo notë, diskutimin që keni pasur përpara se ta shkruani këtë
23 notë?

24 Pë. Po e mbaj mend.

25 Py. Në paragrafin 1 të këtij shënimi, ju përmendni një person

Dëshmitari: Miro Jukiç (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 75

1 i cili tregoni ndër të tjera se ndihet i stresuar për shkak të
2 dokumenteve të rrjedhura në media. A mbani mend që t'ju jetë
3 dhënë ky informacion gjatë kësaj telefonate ose telefonatave
4 të tjera?

5 Pë. Po, e mbaj mend.

6 Z. PACE: [Përkthim] Dua të kërkoj pranimin e këtij
7 dokumenti si provë materiale, të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [E padëgjueshme].

9 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është dokumenti që merr
10 numrin e identifikimit P132.

11 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti tjetër që dua t'ju tregoj -
12 - ju kërkoj ndjesë të nderuar Gjykatës. Dokumenti tjetër që
13 dua t'ju tregoj tani është dokumenti me numër identifikimi nga
14 0089908 deri në 00889908RED, ndarja 229 ju lutem.

15 Py. A e njihni këtë dokument z. dëshmitar?

16 Pë. Po, e njoh këtë dokument.

17 Py. A është nënshkrimi juaj nënshkrimi në fund të këtij
18 dokumenti?

19 Pë. Po, ky është nënshkrimi im në fund të dokumentit.

20 Py. A e mbani mend diskutimin që reflektohet në këtë
21 dokument?

22 Pë. Po, e mbaj mend.

23 Py. Në paragrafët 2 dhe 3 të kësaj note, ju i referoheni një
24 personi që ju ka thënë ju dhe një kolegu tuaj që ai nuk është
25 i shqetësuar për rrjedhjen e informacionit dhe nuk është se ka

1 ndonjë shqetësim serioz. A e mbani mend që t'ju jetë dhënë ky
2 informacion, pra informacioni që jepet në këtë notë?

3 Pë. Po e mbaj mend.

4 Py. Ju e thatë edhe më herët sot që kishte disa persona, të
5 cilët kanë shprehur të njëjtin qëndrim. A është e saktë kjo?

6 Pë. E saktë është.

7 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dua që të
8 pranohet si provë materiale ky dokument.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet. Ju
10 lutem caktojini një numër.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është dokumenti i
12 shënuar si provë materiale P133.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
14 ndjesë nuk e dëgjova. E përmendni dot dhe njëherë?

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Prova materiale P133.

16 Py. Dokumenti që do të doja të tregoja tani është dokumenti
17 nga 091902 deri në 091902RED dhe nënndarja 320. Bëhet fjalë
18 për nënndarjen 320 në dosjen tuaj.

19 Py. A e njihni këtë dokument, e keni parë më përpara z.
20 dëshmitar?

21 Pë. Po, e kam parë.

22 Py. Kjo notë përmend një takim me dikë, emri i të cilit është
23 fshirë. Mund të shohim në paragrafin e parë datën e këtij
24 takimi. Unë nuk do ta përmend datën sepse jemi në seancë të
25 hapur dhe thjesht sa për një masë sigurie plus nuk do të

1 përmend.

2 Ndërkohë që në paragrafin 2 dhe në paragrafin 3 nota
3 thotë, që ky personi ju ka thënë që është pak i shqetësuar për
4 shkak të sigurisë së tij dhe në veçanti është i shqetësuar për
5 një njoftim të caktuar të bërë nga OVL e UÇK-së. A e mbani
6 mend takimin që keni përshkruar në këtë notë?

7 Pë. Po e mbaj mend takimin që kam përmendur.

8 Py. Dhe duke pasur parasysh datën specifike të kësaj note, a
9 e mbani mend n.q.s. ky takim është planifikuar si rezultat i
10 ngjarjeve apo thjesht doli ky takim i paplanifikuar?

11 Pë. Ky takim nuk ishte i planifikuar.

12 Py. A e planifikuat këtë takim juve si rezultat i
13 aktiviteteve që ndodhën në shtator 2020 apo e kishit
14 planifikuar pavarësisht asaj çfarë ndodhi në shtator?

15 Pë. Personi më kontaktoi mua kur rrodhën dokumentet.

16 Py. Kur të kontaktoi ky person?

17 Pë. Personi më kontaktoi mua kur rrodhën dokumentet.

18 Py. Kur të kontaktoi ky person?

19 Pë. Personi më kontaktoi në momentin, në ditën që është
20 përmendur në Notën Zyrtare.

21 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që dokumenti të pranohet si
22 provë materiale.

23 Z. REES: [Përkthim] Kemi kundërshtim lidhur me këtë notë.
24 Me aq sa mund të shohim nuk është bërë ky dokument deri pesë
25 muaj pasi kanë ndodhur ngjarjet.

1 Z. PACE: [Përkthim] Jam i lumtur që t'jua sqaroj. Pra
2 mund t'jua sqaroj ose tani ose më vonë relevancën apo
3 rëndësinë e këtij dokumenti, megjithatë kjo nuk ka të bëjë me
4 pranimin e këtij dokumenti si provë materiale.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë vijoni
6 me sqarimin tuaj.

7 Faleminderit z. Rees.

8 Z. PACE: [Përkthim] Siç u tha nga z. Rees, ne shohim dy
9 datë këtu, data është pak më e vonë dhe a mund të na thoni në
10 fakt sepse e kemi këtë hendek në kokë, pse kemi dy kohë të
11 ndryshme. Dhe a mund të na shpjegoni se pse janë këto dy data
12 të ndryshme.

13 Pë. Ky hendek në kokë ka ardhur si rezultat i mbylljes për
14 shkak të COVID-it dhe nuk kemi pasur mundësi që të shkojmë në
15 zyrë në mënyrë që ne të mund t'i dorëzonim dhe t'i
16 regjistronim të gjithë dokumentet tona në ZyLAB.

17 Py. A e mbani mend ju n.q.s. informacionin e regjistruar në
18 këtë notë e keni regjistruar në të njëjtën ditë apo disa ditë
19 më pas, apo disa muaj më pas?

20 Pë. Unë i mbaj shënim dhe i bëj Nota Zyrtare menjëherë pas
21 takimit ose sa më pranë takimit të jetë e mundur.

22 Py. Tani për të qenë të qartë ju thatë që shënimet i keni
23 mbajtur menjëherë pas takimit ndërkohë që dokumentin e keni
24 dorëzuar në zyrë më pas.

25 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës shpresoj që ta

1 kem sqaruar çështjen.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees, keni
3 ndonjë gjë për të thënë?

4 Z. REES: Mbaj të njëjtin qëndrim. E kundërshtoj sërish
5 pranimin e këtij dokumenti.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
7 Sekretarja t'i japë numër regjistrimi kësaj prove materiale.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është prova materiale
9 me numër P134.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] P134
11 pranohet.

12 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti tjetër që dëshiroj t'ju
13 tregoj është dokumenti me numër referimi 091907 deri në
14 091908RED2 që gjendet në nënndarjen 324.

15 Py. A e njihni këtë dokument z. dëshmitar?

16 Pë. Po, e njoh këtë dokument.

17 Py. Kjo notë i referohet datave të ndryshme të të njëjtit
18 muaj gjatë të cilit ju dhe kolegët tuaj keni kontaktuar me
19 disa persona, emrat e të cilëve janë fshirë.

20 Në paragrafin 2 dhe 3, nota thotë që personat që janë
21 kontaktuar shprehnin zemërim dhe ndjeheshin të kanosur
22 ndërkohë që OVL e UÇK-së kishte bërë publik emrat e tyre. A e
23 mbani mend atë çfarë keni përshkruar në këtë notë dhe këto
24 telefonata të përshkruara këtu?

25 Pë. Po, i mbaj mend këto telefonata.

1 Py. Një detaj z. dëshmitar. N.q.s. do të shikojmë tabelën,
2 shohim që ka edhe "persona të tjerë që kanë qenë të
3 pranishëm", për shembull shikojmë që kemi LA-11. Kujt i
4 referohet LA11?

5 Pë. LA-11 i referohet ndihmësit gjuhësor ose përkthyesit që
6 punon për ZPS-në?

7 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës dëshirojmë që të
8 kërkojmë regjistrimin si provë materiale të këtij dokumenti.

9 Z. REES: [Përkthim] Ndoshta Prokuroria mund të sqarojë
10 pak mospërputhjen e datave.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem na
12 sqaroni pak sepse edhe unë vura re të njëjtin problem.

13 Faleminderit z. Rees.

14 Z. PACE: [Përkthim] Pa diskutim, të nderuar.

15 Py. Pra z. dëshmitar kemi një datë këtu në tabelë që është
16 një datë e ndryshme dhe është disa kohë pas ndodhjes së
17 incidentit, a mund të na e shpjegoni këtë mospërkim të datave?

18 Pë. Ky shënim është mbajtur pas telefonatës që kemi pasur,
19 ndërkohë që dokumenti është ruajtur në ZyLAB atëherë kur kemi
20 pasur mundësi të kthehemi në zyrë.

21 Py. Kur thua, sa për sqarim d.m.th. kur thua që është
22 regjistruar në ZyLAB për çfarë e ke fjalën shkurtimisht?

23 Pë. Në sistemin që kemi ne në ZyLAB.

24 Py. Dhe ky është sistemi i ZPS-së?

25 Pë. Po është sistemi që përdorim ne në ZPS.

1 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar, besoj që sqarimi u bë dhe
2 kërkojmë pranimin e këtij dokumenti si provë materiale.

3 Z. REES: [Përkthim] E kundërshtoj dhe nuk kam asgjë për
4 të shtuar përveçse nuk jam dakord me këtë gjë.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
6 I lutem Sekretares t'i jepni një numër këtij dokumenti.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Pranohet si dokumenti
8 P137 [sipas përkthimit].

9 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti tjetër që dua t'ju tregoj
10 është dokumenti me numër referimi 0093379 deri në 093379RED.
11 Është dokumenti në nënndarjen 352 e dosjes që keni përpara.

12 Py. A e keni parë këtë notë më përpara z. dëshmitar?

13 Pë. Po e kam parë.

14 Py. Në paragrafin 2 të kësaj note thuhet që ju keni marrë një
15 mesazh në shtator të vitit 2020, përmes të cilit një i afërm i
16 një personi, identiteti i të cilit është fshirë thotë që
17 familja e tij ka informuar atë dhe persona të tjerë që emri i
18 personit, emri i të cilit është fshirë është bërë publik
19 përmes dokumenteve të rrjedhura dhe thotë që ai ka vendosur që
20 familjen e tij ta çonte diku tjetër, d.m.th. ta lëvizte nga
21 aty ku ishte. A e mbani mend këtë mesazh që keni marrë dhe që
22 keni përshkruar në këtë paragraf të notës tuaj?

23 Pë. Po, e mbaj mend.

24 Py. A mund ta mbani mend se ku i ka dërguar anëtarët e
25 familjes ky personi që ju ka dërguar mesazhin? Në një qytet

1 tjetër, në një vend tjetër?

2 Pë. I ka dërguar në një shtet tjetër, në një vend tjetër.

3 Py. Paragrafi 4 i së njëjtit shënim thotë që, ju ka
4 kontaktuar një person tjetër të njëjtin muaj, në një datë
5 tjetër. Në fakt kontakti është me një koleg tuajin. Dhe këtu
6 thotë që emri i personit, emri i të cilit është fshirë është
7 bërë publik përmes dokumenteve të rrjedhura.

8 Më përpara na e shpjeguat këtë proces. A mund të na thoni
9 n.q.s. kjo ishte pjesë e procesit që ndiqej për të dhënë këtë
10 informacion?

11 Pë. Po. Siç e shpjegova dhe më përpara, pas rrjedhjes së
12 dokumenteve më 22 dhjetor [sipas përkthimit], ne vendosëm që
13 ta kishim këtë ushtrim dhe telefonata, telefonata që i
14 referohej ky paragrafi ishte pjesë e këtij ushtrimi.

15 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës kërkoj pranimin e
16 kësaj note si provë materiale.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndonjë
18 kundërshtim?

19 Z. REES: [Përkthim] Sërish n.q.s. mund të na ndihmojë
20 Prokuroria për sa i takon datave të cilat janë pjesë e këtij
21 dokumenti që është data në fillim dhe datat e tjera.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka një hendek
23 prej shtatë ditësh.

24 Z. PACE: [Përkthim] Pa diskutim. Jam i lumtur që t'jua
25 sqaroj dallimet e datave.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
2 ndjesë z. Rees se nuk i vura re datat e tjera.

3 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit, avokat. Faleminderit të
4 nderuar Gjykatës.

5 Py. Shohim tre data të ndryshme në këtë dokument, pra kemi
6 një datë që është në të majtë, që është një datë e këtij viti,
7 kemi një datë të shtatorit të vitit që shkoi dhe kemi
8 gjithashtu një datë tjetër të shtatorit që shkoi.

9 A mund të na shpjegosh ju lutem se pse kemi këto tre data
10 të ndryshme në këtij notë?

11 Pë. Mund t'jua shpjegoj. Data e dytë është një gabim.

12 Py. Për të qenë të qartë, d.m.th. për çfarë bëhej fjalë për
13 datën në tabelë apo në tekst?

14 Pë. Në tabelë.

15 Py. Për të qenë të qartë, a flisni për datën në tabelë, a po
16 ju kuptoj siç duhet apo jo?

17 Pë. Jo bëhet fjalë për datën në tekst.

18 Py. Pra data që shikojmë te paragrafi 1 është data që
19 përshkruan atë çfarë keni bërë juve të telefonatës. D.m.th.
20 ngjarja që ka ndodhur referohet tek paragrafi 1?

21 Pë. Jo, tek paragrafi 4.

22 Py. Ju kërkoj ndjesë. Në paragrafin 1, ne kemi datën e
23 mesazhit që është marrë në një datë të caktuar dhe pastaj te
24 paragrafi 4 kemi bisedën telefonike. Dhe është e saktë që këto
25 dy gjëra kanë ndodhur në dy data të ndryshme?

1 Pë. Po, kanë ndodhur në dy data të ndryshme dhe ndërkohë ka
2 pasur dhe një tjetër koleg të përfshirë.

3 Py. Kur i keni regjistruar këto dokumente në ZyLAB? Pra i
4 keni regjistruar në datën në të majtë të dokumentit?

5 Pë. Po, data në të majta në majë të dokumentit.

6 Py. Cilën datë keni zëvendësuar ju me datën në tabelë? Në
7 paragrafin 1 apo datën në paragrafin 4.

8 Pë. Datën në paragrafin 4.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
10 kundërshtim?

11 Z. REES: [Përkthim] Kundërshtimi është i njëjtë si më
12 përpara.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem
14 caktoji një numër si provë materiale.

15 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është dokumenti me
16 numrin e provës materiale P136.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
18 fjala për ju sërish.

19 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që t'i tregohet dëshmitarit
20 dokumenti me kodin 093388 deri në 093388RED, nëndarja 355.

21 Py. A e keni parë më përpara këtë dokument z. dëshmitar?

22 Pë. Po, e kam parë.

23 Py. Kjo notë përmend një telefonatë që i keni bërë dikujt,
24 emri i të cilit është fshirë dhe ky personi që ju ka thënë që
25 edhe megjithëse nuk ndjehej i kërcënuar, ishte i shqetësuar

1 për rrjedhjen e dokumenteve nga ZPS-ja.

2 A e mbani mend bisedën telefonike të përshkruar në këtë
3 notë?

4 Pë. Po, e mbaj mend.

5 Py. Pra sërish në këtë notë kemi dy data, kemi datën në maj
6 të dokumentit që është datë e këtij viti dhe pastaj kemi një
7 datë tjetër të vitit që shkoi. A mund të na e shpjegoni se pse
8 është ky dallim datash?

9 Pë. Kemi dy data të ndryshme. Data në tekst është data kur e
10 kam marrë në telefon dëshmitarin. Ndërkohë që data në fillim
11 të dokumentit në të majtë është data në të cilën e kam
12 regjistruar këtë dokumenti në sistemin e ZyLAB.

13 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj pranimin
14 e këtij dokumenti si provë materiale.

15 Z. REES: [Përkthim] Kundërshtoj.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Rrëzohet.

17 Ju lutem caktoni një numër.

18 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Është dokumenti me
19 numër P137.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pranohet
21 dokumenti P137.

22 Z. PACE: [Përkthim] Dëshiroj që të shfaqet dokumenti nga
23 084233 deri në 084233RED [sipas përkthimit], dhe kjo gjendet
24 në nënndarjen 184.

25 Py. A e keni parë më përpara këtë dokument z. dëshmitar?

Dëshmitari: Miro Jukiç (Seancë e hapur)
Pyetje nga z. Pace

Faqe 86

1 Pë. Po.

2 Py. A e mbani mend diskutimin që përshkruhet në këtë
3 dokument?

4 Pë. Po, e mbaj mend diskutimin.

5 Py. Në paragrafin 1 [sipas përkthimit], ky dokument i
6 referohet një personi që ju tha ju dhe një kolegut tuaj që ai
7 e mbështet punën e Gjykatës por është shumë i shqetësuar që
8 këto dokumente kanë rrjedhur. A e mbani mend që t'ju jetë
9 dhënë informacion i kësaj natyre dhe nga kontakte të tjera?

10 Pë. Po, e mbaj mend.

11 Py. Lidhur me këtë notë, shohim që ka një emër të një
12 Prokurori të Asociuar tek tabela dhe është i njëjti emër
13 personi që ka nënshkruar këtë notë. Po ashtu shohim emrin tuaj
14 tek rreshti "Pjesëmarrës të tjerë" dhe shikojmë gjithashtu
15 edhe faktin që ka qenë i pranishëm një përkthyes.

16 Z. PACE: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë, po vijoja me
17 pyetjen.

18 Z. PACE: [Përkthim]

19 Py. Z. dëshmitar a do të thotë kjo që ndërkohë ju nuk e keni
20 shkruar këtë notë, sepse nuk është nënshkrimi juaj në fund të
21 dokumentit. Ju keni qenë i pranishëm në këtë takim që
22 përshkruhet në këtë notë?

23 Pë. Po, kam qenë i pranishëm në këtë takim.

24 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkojmë pranim
25 të kësaj note si provë materiale.

1 Z. REES: [Përkthim] Kundërshtoj. Dhe dua të trajtoj këtë
2 dhe dua të trajtoj dhe notat e tjera që besoj se do të cekë z.
3 Pace në marrjen e tij të drejtpërdrejtë në pyetje të
4 dëshmitarit.

5 Trupi Gjykues ka dhënë një vendim sa i takon pranimin të
6 dokumenteve përmes paraqitjes së drejtpërdrejtë të provave për
7 Trupin Gjykues më datë 29 shtator 2021. Është parashtrimi i
8 protokolluar F00334 dhe besoj që do të na vinte në ndihmë
9 n.q.s. Trupi Gjykues do të kishte përpara tekstin e këtij
10 vendimi, pasi do të doja t'i referohesha pjesëve të tij të
11 caktuara.

12 Në këtë kërkesë, sigurisht pjesët e tyre lidheshin
13 pikërisht me këto nota. Dhe në paragrafin 90 -

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees
15 përpara se të futemi në detaje të mëtejshme, ju lutem na e
16 thoni se cili është kundërshtimi juaj, d.m.th. është
17 thashethem, është konfrontim, cila është baza për
18 kundërshtimin?

19 Z. REES: [Përkthim] Nuk është në përputhje me vendimin që
20 ka dhënë Trupi Gjykues.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk na duhet
22 që ta kemi vendimin përpara se e kemi shkruar vetë.

23 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë. Me respektin më të
24 madh, është e vështirë që të kërkoj fjalën për të kundërshtuar
25 çdo herë.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Më lejoni të
2 shprehem kështu. Unë e pranoj kundërshtimin tuaj.

3 Z. REES: [Përkthim] Ju jam mirënjohës.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Çështja është
5 që ai nuk ka qenë d.m.th. personi dëshmitari nuk është autor i
6 këtij raporti.

7 Z. REES: [Përkthim] Faleminderit.

8 Z. PACE: [Përkthim] Z. Prokuror, të nderuar Gjykatës
9 atëherë e kuptoj që ky dokument nuk pranohet si provë
10 materiale apo jo?

11 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që ky
12 është një moment i përshtatshëm për të bërë pushimin. A mund
13 t'ju informoj që nuk është se se planifikoj shumë kohë për të
14 vijuar me pyetjen në drejtim të dëshmitarit.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të bëj
16 një pyetje?

17 Z. PACE: [Përkthim] Sigurisht.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A është
19 synimi juaj që të parashtroni më shumë nota nga persona të
20 tjerë të cilët nuk janë autori apo që nuk i kanë shkruar këto
21 nota?

22 Z. PACE: [Përkthim] Po të nderuar Gjykatës e kam parasysh
23 vendimin që ju morët më përpara pra sot paradite dhe do të
24 mundohem që të jem sa më konciz të jetë e mundur.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është shumë e

1 vështirë të marrësh në mënyrë të drejtpërdrejtë në pyetje dikë
2 që nuk është këtu. Kështu që ju lutem të keni parasysh nga
3 sqarimet që kemi dhënë gjatë paradites dhe pyetjeve të
4 mundshme dhe shikojini dhe njëherë, formulojini dhe njëherë
5 pyetjet e mundshme në pushimin e drekës.

6 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Kemi
8 përfunduar seancën.

9 Ndërkohë dëshmitari mund të dalë nga salla e gjyqit.

10 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara sesa
12 t'ju jap fjalën, më lejoni të sqaroj që fakti që këto nota që
13 kemi pranuar po dëgjohen dhe po pranohen si prova materiale
14 dhe dëshmia e dëshmitarit lidhur me to. E kuptoj që personi që
15 i ka shkruar disa prej tyre nuk është këtu për tuaj marrë në
16 pyetje nga ju.

17 Po fakti që e dëgjojmë këtë dëshmi ose e pranojmë si provë
18 materiale, pra nuk është tregues i peshës që ne do t'i japim
19 një dëshmie të tillë. Trupi Gjykues është i ndërgjegjshëm për
20 mungesën e hapësirës së Mbrojtjes për të bërë pyetje efektive
21 nga ana e saj për të sqaruar më shumë situatën që përshkruhet
22 nga nota të tilla.

23 Thjesht sa për të sqaruar që e kuptojmë situatën tuaj,
24 megjithatë po i pranojmë ato si thashetheme për arsye që ato
25 janë të rëndësishme, provuese dhe besojmë që ato janë

26

1 autentike sepse ato që kemi pranuar janë prova materiale, në
2 të cilat ka qenë i përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë
3 dëshmitari.

4 Z. REES: [Përkthim] Lidhur me këtë çështje e kuptoj që
5 dëshmitari thotë që nota në vetvete është e saktë sa i takon
6 asaj çfarë i është thënë atij. Megjithatë lidhur me vendimin,
7 lidhur me mocione për paraqitjen e provave drejtpërdrejt për
8 Trupin Gjykses, juve përcaktuat që është e rëndësishme që të
9 vërtetohet vërtetësia e çështjeve të cilat parashtrohen në
10 notat për të cilat pyetet dëshmitari. Dhe mbase ajo çfarë
11 është shkruar nga persona të tjerë, staf tjetër i ZPS-së shkon
12 përtej asaj çfarë është sqaruar në vendimin tuaj.

13 Në përputhje me vendimin e Trupit Gjykses duam të
14 parashtrojmë që ajo çfarë është thënë nga ky dëshmitar nuk
15 mund të pranohet për të vërtetuar vërtetësinë ose për të
16 përcaktuar vërtetësinë e palëve të treta, sepse kjo do të
17 ishte në kundërshtim me vendimin që ka marrë Trupi Gjykses për
18 mocionet e paraqitura në prova të drejtpërdrejta Trupit
19 Gjykses.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Arsyeja që
21 pse e kemi marrë këtë vendim është që kishim nevojë për më
22 shumë informacion. Ato nuk janë pranuar në mocionin e
23 paraqitjes e provave të drejtpërdrejta për Trupin Gjykses. Kam
24 përshtypjen që jam i saktë. D.m.th. me fjalë të tjera ajo
25 çfarë po mundohem të them është që tani na kanë dhënë më shumë

1 informacion dhe prandaj e lejojmë ofrimin e këtyre
2 dokumenteve.

3 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë sepse një dokument
4 mund të pranohet për një arsye ose për më shumë se një arsye.
5 Në paragrafin 93 të vendimit tuaj, të nderuar Gjykatës ju
6 thoni që:

7 "Trupi Gjykues gjen vlerë provuese të përmbajtjes së
8 notave të kontaktit n.q.s. ka. Dhe për pasojë, arsyet duhet që
9 të jenë drejtësia e procedurave dhe për këtë arsye do të duhet
10 që të sigurohemi që notat përcaktojnë vërtetësinë e asaj çfarë
11 reflektohet në notat përkatëse. Vendimi në fjalë nuk cenon
12 përgjegjësinë e ZPS-së për të përdorur ose për të kërkuar
13 pranimin e notave të caktuara të kontaktit përmes dëshmisë së
14 dëshmitarit që ka qenë autor i notave; ose dy, qëllimit të
15 kufizuar të përshkrimit të procedurës së ndjekur nga ZPS-ja
16 gjatë intervistimit të dëshmitarëve, si dhe burimeve të
17 përdorura dhe kohës së shpenzuar për këto intervista deri në
18 masën që dëshmitarë të tjerë kanë njohuri mbi këto çështje".

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ndërmjet të
20 tjerave, pra ka të bëjë gjithashtu edhe me mbështetjen e
21 dëshmisë së këtij dëshmitari lidhur me atë se çfarë ka zbuluar
22 ai gjatë këtyre diskutimeve.

23 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj këtë gjë që qëllimi është i
24 kufizuar. E kuptoj që nota është pranuar sepse na dëshmon neve
25 se çfarë i kanë thënë atij, palët me të cilët ai ka diskutuar.

1 Megjithatë në përputhje me vendimin që keni marrë juve në
2 vendimin e cituar më sipër nuk duhet të shkojë më tepër kësaj
3 dhe nuk duhet të përdoret për të vërtetuar ose për të
4 përcaktuar vërtetësinë e diçkaje që është deklaruar nga një
5 palë e tretë dhe nuk duhet që të përdoret si element për
6 mbështetjen e këtij informacioni.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në fakt
8 dokumenti po pranohet për atë çfarë thotë dokumenti.

9 Sigurisht kjo ka të bëjë me peshën e dëshmisë. Kjo është
10 diçka të cilën ne nuk e kemi vendosur akoma. Pra ne e dëgjuam
11 dëshminë, ne i kemi pranuar provat materiale, do të vendosim
12 më pas se çfarë peshe do t'i japim dëshmisë së dhënë për
13 dëshminë në fjalë. Jua thashë edhe më përpara që kemi disa
14 kufizime të caktuara lidhur me dëshminë apo këtyre
15 dokumenteve, edhe kjo është diçka që do ta gjykojmë.

16 E vlerësoj argumentet tuaja dhe qëndrimin tuaj, por nuk e
17 di, nuk e kuptoj drejtë se çfarë po na kërkon të bëjmë.

18 Z. REES: [Përkthim] Përpara momentin nuk po i kërkoj
19 ndonjë gjë, z. Kryetar i Trupit Gjykses nuk është se po ju
20 kërkoj ndonjë gjë specifike megjithatë do duhet të merren
21 parasysh këto pika.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do t'i kemi
23 parasysh komentet tuaja dhe prandaj ne kërkuar që dëshmitari
24 të ishte i pranishëm dhe të mos i merrnim dëshmitë të çuara
25 apo të dhëna drejtpërsëdrejti nga Prokuroria. Në mënyrë të

1 tillë që dëshmitari të ishte i pranishëm në seancë dhe në
2 mënyrë të tillë që ju të kishit mundësi që t'i bënit pyetjet
3 tuaja dëshmitarit.

4 Z. REES: [Përkthim] Unë në fakt nuk mund t'i bëj dot
5 pyetje dëshmitarit për t'i thënë n.q.s. është e vërtetë apo jo
6 ky dokument. Arsyeja që pse jam në këmbë është fakti që unë
7 nuk do të kem mundësi që t'i bëj pyetjet e mia dëshmitarit
8 deri të enjten në mëngjes sepse kemi dëgjuar një dëshmi, e
9 cila nuk është e parashtruar në deklaratë edhe kjo është diçka
10 e cila është vijimësia sa çfarë kam kërkuar dhe gjatë javës.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
12 shqyrtoj këtë gjë dhe do kthehem sërish tek juve.

13 Z. Pace, nuk doja t'ju anashkaloja.

14 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit. Vetëm shkurtimisht do
15 të doja të thoja që ne kemi rreth 15 ose deri në 30 minuta
16 ende të planifikuara për t'i bërë pyetje dëshmitarit.

17 Pra thjesht edhe njëherë doja të thoja që më duhen 15-30
18 minuta për të përfunduar me marrjen e drejtpërdrejtë të
19 pyetjeve të dëshmitarit. Dhe është në favor të shpejtësisë së
20 procedurës që të vijojmë menjëherë me marrjen në pyetje të
21 Mbrojtjes. Pra sipas rregullit 102(3), sipas nxjerrjes për sa
22 i takon rregullit 102(3) nuk kishte arsye që pse të jepnin
23 deklaratën e dëshmitarit kështu që nuk shikojmë asnjë lloj
24 arsyeje pse mos të fillojë marrjen në pyetje Mbrojtja sot
25 pasdite.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem a na
2 e thoni pak se pse është e vështirë për juve që të merrni në
3 pyetje dëshmitarin sot pasdite?

4 Z. REES: [Përkthim] Arsyeja është se ka pjesë të
5 rëndësishme të dëshmisë së tij që nuk e kemi parë në
6 deklaratat e tij dhe nuk kemi shënime për të.

7 E kuptoj vendimin për temat e përfshira megjithatë nuk
8 kemi pasur hollësi lidhur me deklaratat e tij. E kuptojmë
9 vendimin që morët ju të nderuar Gjykatës sot paradite, dhe po
10 ashtu jam i ndërgjegjshëm për njoftimet e kohës që na duheshin
11 më përpara dhe shpresojmë që ju të na kuptoni.

12 Dhe unë personalisht jam i sigurt jam i qëndrimit që ne
13 nuk do të humbim kohën n.q.s. do të na jepni kohë të
14 reflektojmë lidhur me atë çfarë është thënë sot dhe çfarë
15 është regjistruar në transkript dhe n.q.s. do të na jepet
16 mundësia që të vijojmë me marrjen në pyetje të këtij
17 dëshmitari të enjten, pra pasi të jemi përgatitur për këtë.

18 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

19 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit të nderuar.

20 Thjesht doja të thoja që nuk është se kemi dëgjuar ndonjë
21 gjë habitëse nga ajo çfarë dëgjuam sot. Pjesa më e madhe e saj
22 është e përmbledhur në deklaratë dhe n.q.s. e kombinon atë me
23 përmbledhjet e dëshmisë së parashikuar, pra mendoj që nuk
24 është se ka ndonjë gjë për tu çuditur dhe kjo është në
25 përputhje me rregullat e procedurës dhe mbi bazën e

1 Rregullores për Organizimin e Proceseve. Pra ne kemi qëndrimin
2 që nuk ka asnjë arsye se pse ta shtyjmë marrjen në pyetje nga
3 Mbrojtja. N.q.s. ka ndonjë çuditëse ose habitëse nga ajo çfarë
4 kemi dëgjuar sot atëherë ka të drejtë Mbrojtja që të kërkojë
5 kohë shtesë për tuaj përgatitur.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
7 shqyrtojmë gjatë pushimit të drekës edhe kur të kthehemi do
8 t'ju themi se cili është pozicioni ynë. Mund të duhet që të
9 vijoni me marrë në pyetje sot ose jo megjithatë më duhet të
10 them që unë u ktheva dhe lexova dhe njëherë të gjithë
11 materialin dhe nuk kam dëgjuar asgjë nga dëshmitari sot që
12 mund të mos parashikohen nga leximi i materialeve të nxjerra
13 dhe çështjeve të tjera.

14 Z. REES: [Përkthim] E kuptoj qëndrimin tuaj të nderuar
15 Gjykatës. Pra e kuptoj që le të themi thellësia juaj është më
16 e madhe sesa e imja megjithatë, pra lidhur me atë çfarë
17 dëgjova sot ka gjëra të cilat nuk i kam perceptuar, nuk i kam
18 parashikuar, janë tërësisht të reja për mua dhe kështu që do
19 të doja që të kisha më tepër kohë që t'i shtjelloja ato me më
20 tepër detaje.

21 Do të doja që ta bëja këtë gjë në mënyrë më koncize, më
22 efektive dhe më efikase dhe besoj që kjo mund të bëhej duke më
23 dhënë më shumë kohë për t'u përgatitur.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po ju z.
25 Cadman dëshironi që të vijoni me marrjen në pyetje të

1 dëshmitarit sot?

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Shumë thjesht, shkurtimisht,
3 mbështetur në diskutimet që kemi organizuar më herët gjatë
4 kësaj jave, ne kemi pasur idenë që do të na jepej kohë deri të
5 enjten. Jam dakord me atë çfarë tha z. Rees që në fakt janë
6 ngritur çështje, të cilat janë të reja apo të paparashikuara
7 për ne.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do ta
9 shqyrtojmë këtë çështje dhe do të marrim një vendim. Do t'jua
10 bëjmë atë me dije pas pushimit të drekës.

11 Tani marrim pushimin e drekës.

12 --- Pauza e drekës fillon në orën 13.08

13 --- Seanca rifillon në orën 14.30

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se ta
15 kthejmë dëshmitarin do të trajtojmë pikat që ngriti z. Rees.

16 Z. Rees nuk dua që të kalojë kjo në një shprehi por
17 ndoshta keni dhe të drejtë.

18 Në vendimin në lidhje me provat jогоjore F33 [sipas
19 përkthimit], paragrafët 93-94, ne e kemi bërë të qartë që
20 shënimet për kontaktet nuk do të pranohen në lidhje me
21 përcaktimin e të vërtetës për çështjet që pretendohen në ato
22 shënime nga dëshmitarët me të cilët ka folur Zyra e Prokurorit
23 të Specializuar.

24 Trupi Gjykses gjithashtu mban parasysh shënimet që
25 sugjeron se z. Jukiç i është thënë nga dëshmitarë në lidhje me

1 frikën dhe shqetësimet që kanë ata. Në qoftë se Mbrojtja
2 kundërshton se kjo është thënë, atëherë Mbrojtja mund të
3 kundërshtojë këtë pohim të dëshmitarëve gjatë pyetjeve të saj
4 për dëshmitarin.

5 Kjo nuk do të thotë se Trupi Gjykues nuk mund të
6 mbështetet në shënimet e pranuar si prova për të vërtetuar se
7 z. Jukiç ka folur me ata dëshmitarë ose se çfarë i kanë thënë
8 ata dhe kjo qëndron në paragrafin 94 të vendimit për pranimin
9 e provave jогоjore, ku thuhet se ZPS-ja mund të përdorë dhe të
10 kërkojë pranimin e disa shënimeve për kontakte nëpërmjet
11 paraqitjes së provave të autorëve të atyre shënimeve.

12 Kjo gjithashtu nuk e pengon ZPS-në që të nxjerrë dëshmi
13 nga z. Jukiç në lidhje me dijeninë e tij për këto kontakte
14 gjatë pyetjeve të drejtpërdrejta që ka.

15 Tani në lidhje me kërkesën tuaj për fillimin e pyetjeve
16 për z. Jukiç javën e ardhshme Trupi Gjykues qëndron pas
17 mendimit të vet se asgjë nga kjo dëshmi e deritanishme e z.
18 Jukiç nuk është e re apo diçka për të cilën nuk ka pasur
19 njohuri Mbrojtja.

20 Sidoqoftë Mbrojtja, më falni Trupi Gjykues ju miraton
21 kërkesën për të filluar pyetjet për z. Jukiç në fillim të
22 javës, në fund të javës së ardhshme. Në atë mënyrë, pyetjet
23 tuaja do të jenë më koncize dhe mund të bëhen në mënyrë më
24 efektive.

25 Përpara se ta mbyllim seancën e sotshme ne do të

1 vazhdojmë edhe njëherë me dëshminë e drejtpërdrejtë të
2 dëshmitarit.

3 A mund ta sillni dëshmitarin në sallë znj. Sekretare?
4 Z. PACE: [Përkthim] Ndërsa e presim dëshmitarin vetëm një
5 qartësi në lidhje me klasifikimin e provave materiale. Unë
6 thashë më herët në lidhje me dy provat e para që u paraqitën
7 se statusi i tyre duhet të mbetet konfidencial. Parashtrimet
8 që i bëra në lidhje me ato dy prova kanë të bëjnë edhe me të
9 gjitha provat që u paraqitën sot.

10 N.q.s. Trupi Gjykues dëshiron që këto dokumente të jenë
11 publikisht të disponueshme në faqen e internetit të Dhomat e
12 Specializuara. ZPS-ja duhet të bëjë një kërkesë përkatëse për
13 zbatimin e redaktimeve në ato dokumente.

14 [Dëshmitari fillon dëshminë]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
16 z. Pace.

17 Z. Jukiç mund të uleni. Tani do të vazhdojmë me pyetjet e
18 Prokurorisë.

19 Z. Pace keni fjalën.

20 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit.

21 Py. Mirëdita z. dëshmitar.

22 Pë. Mirëdita.

23 Py. Më herët sot e diskutuam deklaratën tuaj dhe ju thatë që
24 shembujt e përmendur aty i bazoni në kontaktet që i keni pasë
25 vetë ju me dëshmitarët dhe në kontaktet që kolegët tuaj kanë

1 pasur me dëshmitarët dhe që ju i keni shqyrtuar dhe i
2 referohem faqes 72 të transkriptit të sotshëm, rreshtat 1 deri
3 në 10.

4 Tani do t'ju tregoj përsëri deklaratën tuaj. Është
5 dokumenti me numër 084008 deri në 084010, është në nënndarjen
6 180.

7 Z. PACE: [Përkthim] Të shkojmë tek faqja 084089, më falni
8 009.

9 Py. Do të lexoj nga paragrafi 11, ku thuhet:

10 Z. REES: [Përkthim] Përpara se të vazhdojë z. Pace.
11 N.q.s. qëllimi i këtyre pyetjeve është që të nxirret përfundim
12 se shembujt e përmendur në këto shënime bazohen në kontakte të
13 personave të tjerë dhe nga shënime autori i të cilave nuk
14 është vetë dëshmitari, atëherë ne parashtrojmë se këto nuk
15 janë të pranueshme sepse dalin jashtë vendimit të Gjykatës.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace.

17 Z. PACE: [Përkthim] Po i nderuar Gjykatës, unë e kam
18 ndërmend që të bëj disa pyetje. Do t'i bëj pyetje dëshmitarit
19 në lidhje me atë se mbi çfarë i bazon shqyrtimet e veta në
20 lidhje me këto shënime dhe do t'i tregoj dëshmitarit ato
21 dokumente dhe pastaj do të vazhdojmë që andej.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni z.
23 z. Pace.

24 Z. PACE: [Përkthim]

25 Py. Paragrafi 11 i deklaratës thotë si vijon:

1 "Një dëshmitar tha se ishte informuar nga miqtë se emri i tij
2 ishte në dokumentet konfidenciale dhe ai menjëherë mori masa
3 për të rritur sigurinë e fëmijëve të tij. Ai theksoi se kishte
4 filluar të ndihej sikur njerëzit e kishin izoluar atë dhe
5 familjen e tij. Dhe se njerëzit me sa dukej nuk bënë ndonjë
6 farë dallimi midis dëshmitarëve dhe spiunëve. Dhe gjithashtu
7 shtoj se ndihej sikur familja e tij ishte e rrezikuar".

8 Z. PACE: [Përkthim] Përpara se të bëj pyetjen time, dua
9 që të nxjerrin në ekran versionin në anglisht të deklaratës me
10 numër 084247 dhe 084248RED.

11 Z. REES: [Përkthim] Si duket e kisha me të drejtë atë që
12 e thashë. Z. Pace po përpiqet të nxjerrë përmbajtjen e
13 shënimeve të kontaktit me dëshmitarët që nuk i ka përpiluar ky
14 dëshmitar. Dhe kjo është në shkelje të urdhrit të Trupit
15 Gjykues.

16 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës ky është i njëjti
17 kundërshtim që u bë dhe më herët, por ju më lejuat që të
18 vazhdoj me pyetjet e mia.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Të fillojmë
20 njëherë me fazën paraprake. A ka ky dëshmitar diçka të bëjë me
21 krijimin e këtyre dokumenteve?

22 Z. PACE: [Përkthim] Në paragrafin që e lexova dhe kjo që
23 u tha më herët në faqen 72 të transkriptit, rreshtat 1 në 10,
24 shihet se për qëllimin e krijimit të një deklarate, ai, pra
25 dëshmitari ka rishikuar edhe shënimet që i kanë bërë të

1 tjerët.

2 Dhe mbas këtij paragrafi që lexova, unë do të kërkoj
3 bazën mbi të cilën është mbështetur dëshmitari kur ka nxjerrë
4 këtë përfundim. Për mendimin tonë të nderuar Gjykatës, kjo
5 është brenda udhëzimeve që na i dhatë sot në mëngjes.

6 [Anëtarët e Trupit Gjykues këshillohen]

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E refuzojmë
8 kundërshtimin. E rrëzojmë kundërshtimin.

9 Vazhdoni z. Pace.

10 Z. PACE: [Përkthim]

11 Py. Z. dëshmitar -

12 Z. CADMAN: [Përkthim] U ngrita në këmbë ndërkohë që po
13 kuvendonit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Urdhëroni z.
15 Cadman.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] Ju pyetët Prokurorin n.q.s.
17 dëshmitari mori pjesë në shkrimin e këtyre raporteve. Nuk
18 përmendet askund kjo. Kemi përpara vetëm një Notë Zyrtare. Nuk
19 përmendet aty ky dëshmitar.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju
21 faleminderit.

22 Vazhdoni z. Pace.

23 Z. PACE: [Përkthim]

24 Py. Z. dëshmitar, përqendrohuni te Shënimi Zyrtar që është në
25 të majtë të ekranit dhe në nënndarjen 188. Në paragrafët 1

1 deri në 3 të këtij Shënimi Zyrtar përmendet dikush që ka thënë
2 se disa miq të tij i kishin thënë se emri i kishte dalë në
3 dokumentet që ishin bërë publike nga OVL UÇK-ja dhe se ky
4 person kishte marrë fëmijët nga shkolla menjëherë sa kishte
5 mësuar për këtë informacion.

6 Në paragrafin 6 të Shënimit Zyrtar thuhet se ky person
7 filloi të ndjente se njerëzit kishin filluar ta izolonin atë
8 dhe familjen, se njerëzit nuk bënë dallim midis dëshmitarëve
9 dhe spiunëve dhe se rrjedhja e informacionit kishte rrezikuar
10 familjen e tij.

11 Z. dëshmitar, nga kjo që dëgjuat pra që e lexova në
12 paragrafin 11 të kësaj deklarate, a mund të na konfirmoni
13 n.q.s. ky paragraf në këtë deklaratë tuajën bazohet në këtë
14 shënim që e lexova.

15 Pë. Paragrafi 11 bazohet në atë shënim.

16 Py. Dhe ky shënim nuk përmend pjesëmarrjen tuaj në
17 kontaktimin e këtij personi, atëherë a kam të drejtë të
18 konstatoj se njohuria juaj në lidhje me këtë informacion
19 bazohet vetëm në notën që keni rishikuar dhe që është
20 përpiluar nga kolegët tuaj?

21 Pë. Jo vetëm nga ajo, por edhe nga takimi.

22 Py. Për cilin takim e keni fjalën?

23 Pë. Një takim ku mora pjesë, ku isha i pranishëm.

24 Py. A e keni fjalën për një takim ku keni qenë si i pranishëm
25 që përmendet në dokumentin në anën e majtë?

1 Pë. Po.

2 Py. Atëherë pse nuk përmendeni aty si një person që ka qenë i
3 pranishëm në takim?

4 Pë. Nuk e di.

5 Z. PACE: [Përkthim] Tani do të kaloj në një paragraf
6 tjetër të deklaratës dhe ky është paragrafi 12 dhe përsëri
7 deklarata është dokumenti në anën e djathtë. Për qartësi ka
8 numrin 084008 deri në numrin 084010.

9 Py. Dhe paragrafi 12 thotë, më falni 8 thotë:

10 "Një dëshmitar tjetër tha se pasi që i kishte dalë emri
11 në dokumentet konfidenciale njerëzit kishin filluar ta
12 shikonin atë dhe familjen e tij në një mënyrë tjetër dhe se
13 puna, biznesi i tij kishte humbur klientët".

14 Z. PACE: [Përkthim] I kërkoj Sekretares që në vend të
15 këtij dokumenti në të majtë të vendosë dokumentin 085880 deri
16 në 085883, nëndarja 191.

17 Z. REES: [Përkthim] Që të mos vijmë në një situatë kur
18 Prokuroria nxjerr dëshminë e këtij dëshmitari mbas një Shënimi
19 Zyrtar dhe pastaj kalon në një takim, ndoshta mund të fillojmë
20 me përfshirjen e dëshmitarit në punën e tij dhe se çfarë ka
21 bërë ai.

22 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës unë mendoj që jam
23 ai që i bëj pyetjet e drejtpërdrejta për dëshmitarin. Dhe më
24 është lejuar prej jush deri tani që të vazhdoj në këtë mënyrë.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vazhdoni

1 Prokuror.

2 Z. PACE: [Përkthim]

3 Py. Z. dëshmitar, ju lutem shikoni shënimin që keni në anën e
4 majtë të ekranit që është në nënndarjen 191 dhe ajo ka të bëjë
5 me një telefonatë që ka bërë kolegu juaj në shtator të vitit
6 2020. Dhe në paragrafin 7 dhe 8, që janë në faqen e parë,
7 bëhet fjalë për atë se çfarë i ka thënë një person kolegut
8 tuaj, pra se për shkak të rrjedhjes së informacionit pra të
9 dokumenteve të ZPS-së dhe publikimit të këtyre dokumenteve në
10 media, njerëzit kishin filluar ta shikonin familjen e tij
11 ndryshe, se kishte humbur biznesin, punën, klientët dhe se kjo
12 i kishte sjellë familjen e tij në vështirësi financiare.

13 Z. dëshmitar, a mund të na konfirmoni n.q.s. ky paragraf
14 që ua lexova pak më parë nga deklarata, është e njëjtë gjë si
15 në paragrafin 12, d.m.th. bazohet në informacionin e Notës
16 Zyrtare, që e shikojmë në anën e majtë të ekranit.

17 Pë. Po.

18 Py. A mund të na qartësoni n.q.s. dijenia juaj për këtë
19 informacion të përmbajtur në Notën Zyrtare që e pamë është
20 diçka që ju e keni mësuar nga një takim apo nga një rishikim i
21 dokumenteve që keni kryer për qëllimet e përpilimit të
22 deklaratës.

23 Pë. Këtë informacion e kam mësuar gjatë rishikimit të
24 dokumenteve.

25 Py. Tani do të shkoj tek paragrafi 10. Numri i deklaratës

1 është i njëjtë 084008 deri në 084010. Do të lexoj paragrafin
2 10 ku thuhet:

3 "Dëshmitari theksoi se për shkak të bërjes publike të
4 informacionit konfidencial, numri i njerëzve që potencialisht
5 mund t'i shkaktonin dëm familjes së tij ishte rritur".

6 Z. PACE: [Përkthim] Tani në të majtë të këtij dokumenti
7 dua të vendos në ekran dokumentin me numër 089938 dhe 0899939,
8 nënndarja 234.

9 Py. Në këtë Shënim Zyrtar që e shikoni në anën e majtë të
10 ekranit përmenden një telefonatë që e ka bërë një kolegu juaj
11 z. dëshmitar. E ka marrë në telefon një person në shtator të
12 vitit 2020. Dhe në paragrafin 3, të kësaj faqeje e parë
13 përmendet një person që i ka thënë kolegut tuaj se ai e ka
14 ditur për rrjedhjen e informacionit, se ai ka qenë i zemëruar
15 për shkak të kësaj rrjedhjeje informacioni dhe se anëtarët e
16 familjes së tij në Kosovë nuk janë të sigurt sepse OVL UÇK-ja
17 ka me mijëra anëtarë.

18 Në paragrafin 5 të po këtij shënimi, në të njëjtën faqe
19 shohim që përmendet i njëjti person duke thënë se mendon që
20 rrjedhja e informacionit ka rritur numrin e personave që
21 potencialisht mund t'i shkaktojnë dëm familjes së tij.

22 Z. dëshmitar, a mund të konfirmoni se paragrafi 10 që ua
23 lexova bazohet në përmbajtjen e kësaj Note Zyrtare?

24 Pë. Po, mund të konfirmoj.

25 Py. Dhe në këtë rast përsëri a mund të na qartësoni bazën e

1 njohurisë tuaj, këto njohuri, këtë informacion, a e keni nga
2 fakti që morët pjesë në ato takime apo nga rishikimi i
3 dokumenteve që patë, që bëtë gjatë përgatitjes së deklaratës?
4 Pë. Mësova për këtë informacion gjatë shikimit, shqyrtimit të
5 Notës Zyrtare.

6 Z. PACE: [Përkthim] Dokumenti në të majtë mund të hiqet.
7 Dhe tani të kalojmë tek paragrafi 8 i deklaratës.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Pace,
9 vetëm një moment, e kam të drejtë kur them se doni të
10 mbështeteni në këtë informacion në ndonjë mënyrë. A do të
11 përdoret për diçka? A do ta paraqisni këtë si provë?

12 Z. PACE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, në bazë të
13 udhëzimeve tuaja, nuk e kam ndërmend që këto Shënime Zyrtare
14 t'i paraqes si prova Gjykatësi.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe këto tre
16 deklarata nuk kanë ndonjë vlerë provuese dhe vetëm po ju bëj
17 pyetje që ta di sesa gjatë do të vazhdoni me këtë.

18 Z. PACE: [Përkthim] Po i nderuar Gjykatës, do t'i kaloj
19 edhe paragrafët e tjerë dhe do ta bëj të njëjtën gjë.

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni
21 ndërmend që këta paragrafë t'i paraqisni si prova?

22 Z. PACE: [Përkthim] Jo i nderuar Gjykatës, vetëm do t'i
23 paraqes Shënimet Zyrtare në përputhje me udhëzimin tuaj që
24 dhatë sot në mëngjes. N.q.s. më lejoni deklarata do të
25 paraqitet si provë në bazë të rregullit 154.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë nuk e
2 shoh kuptimin e këtyre pyetjeve që i bëni. Ne ju kemi pyetur
3 se a do të sillni dëshmitë e tjera që do të dëshmojnë për këtë
4 gjë. Ju na keni thënë jo. Ju na keni thënë se do të dëgjoni
5 dëshmi të tjera. Ne ju kemi lejuar, mirëpo ju nuk po arrini
6 ndonjë gjë me këtë, sepse këto që po bëni tani nuk kanë ndonjë
7 vlerë provuese.

8 Por mund të vazhdoni gjithsesi.

9 Z. PACE: [Përkthim] Në rregull të nderuar Gjykatës. Vetëm
10 të konsultohem me kolegët e mi në lidhje me parashtrimet që
11 bëtë.

12 [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

13 Z. PACE: [Përkthim] Faleminderit që më lejuat të diskutoj
14 me kolegët.

15 Në këtë rast mund të them se nuk kemi më pyetje për këtë
16 dëshmitar dhe këtu përfundojmë pyetjet kryesore nga ana jonë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
18 z. Pace.

19 Siç thamë më herët Mbrojtja do t'i bëjë pyetjet e saj të
20 enjten që vjen në orën 09.30.

21 Po z. Pace.

22 Z. PACE: [Përkthim] Dhe një gjë për sqarim.

23 Megjithëse i shtymë pyetjet javën që vjen bazuar në
24 urdhrin tuaj për kryerjen e procedurave, lista e provave
25 materiale do të nxirret tani.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë ju
2 duhet për t'i nxjerrë dokumentet tuaja për kundërpjetje?
3 Përgjigjja ishte sot më vonë.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Anëtarët e
5 Trupit Gjykses do t'i bëjnë disa pyetje dëshmitarit duke
6 filluar nga Gjykatësi Gaynor.

7 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar.

8 Pyetje nga Trupi Gjykses:

9 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Mirëdita z. Jukiç. Në
10 dëshminë që dhatë deri tani thatë që keni punuar me ZPS-në që
11 nga shtatori 2019?

12 E pranoj këtë dhe - po si rezultat i COVID-it janë bërë
13 ndërprerje sigurisht. Megjithatë, a mund të na thoni sesa
14 persona, me sa persona keni pasur punë në kuadër të punës
15 suaj, detyrave zyrtare në zyrën e ZPS-së që kur keni filluar
16 punë në shtator të 2019-s?

17 Pë. Kur fillova punë në ZPS, ishim dy punonjës që merreshim
18 me sigurinë e dëshmitarëve dhe një kryetar i ekipit. Pastaj në
19 pranverë 2020, ekipi u shtua, u bëmë pesë veta dhe një kryetar
20 i ekipit.

21 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Nga dëshmia juaj kuptoj që
22 keni punë me hetues dhe prokurorë, kështu?

23 Pë. Po ashtu është.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dhe keni punë me ta çdo ditë
25 a çdo javë?

26

1 Pë. Çdo ditë.

2 GJYKATËSI GAYNOR: Në rregull. Si rezultat i përvojës tuaj
3 profesionale që nga shtatori 2019, a keni ndonjë arsye të
4 besoni se ndonjë anëtar aktual apo i dikurshëm i ZPS-së është
5 përfshirë në ndonjë farë mënyre në dorëzimin e informacionit
6 të paautorizuar OVL UÇK-së?

7 Pë. Jo.

8 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Keni ndonjë arsye të besoni
9 se ndonjë person që vepron nën udhëzimet apo nën kontrollin e
10 ZPS-së është përfshirë në ndonjë farë mënyre në dorëzimin e
11 informacionit të paautorizuar OVL UÇK-së?

12 Pë. Jo.

13 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Faleminderit z. Jukiç.
14 Faleminderit z. Kryetar.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit Gjykatës.

16 Mirëdita z. Jukiç.

17 Pë. Mirëdita.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Nga rrëfimi juaj, mësova
19 se është pjesë e punës suaj dhe ekipit tuaj që të bëni
20 vlerësime sigurie për dëshmitarët, kështu është?

21 Pë. Po, është e saktë.

22 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të më thoni në
23 përgjithësi se cilët janë faktorët apo aspektet që ju merrni
24 në konsideratë për të bërë një vlerësim të tillë?

25 Pë. Pas një interviste, punonjësi që merret me sigurinë e

1 dëshmitarëve ai bën një intervistë të shkurtër me dëshmitarët
2 ku mbledh të gjitha të dhënat lidhur me dëshmitarin, familjen
3 e tij, të dhëna për kontaktet dhe për kërcënimin. N.q.s. ka
4 pasur ndonjë kërcënim më përpara, nëse dëshmitari ndjehet i
5 pasigurt apo i kërcënuar nga dikush apo nëse ai pret ndonjë
6 lloj kërcënimi. Pra kryesisht përqendrohemi tek vlerësimi i
7 kërcënimit pas intervistës.

8 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Konteksti në të cilën
9 dëshmitari në fjalë gjendet, vendndodhja qoftë në Kosovë apo
10 jashtë saj, ky do të ishte një aspekt me rëndësi për qëllimet
11 tuaja?

12 Pë. Po. Ne i marrim parasysh të gjitha faktet; kështu që
13 ndryshon nëse personi jeton jashtë Kosovës apo në Kosovë dhe
14 çfarë lloj dëshmitari është, nëse dëshmitari është viktimë apo
15 thjesht viktimë apo një dëshmitar i brendshëm. Pra i marrim të
16 gjithë këto aspekte në konsideratë në vlerësimin që bëjmë.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Do t'i kthehem çështjes së
18 viktimave. Po dua të më thoni diçka, pra ju sapo thatë që
19 merrni parasysh nëse personi në fjalë gjendet në Kosovë apo
20 jashtë saj. Përse ka rëndësi kjo për vlerësimin tuaj të
21 kërcënimit të sigurisë nëse dikush mund të jetë në Kosovë në
22 atë kohë?

23 Pë. Sepse në Kosovë si ZPS kemi të drejtë, kemi njerëz
24 përfaqësues aty të cilët mund të reagojnë dhe mund të
25 ndihmojnë personin, por në vende të tjera na duhet të kërkojmë

1 ndihmën e autoriteteve të tjera, të dërgojmë kërkesë për
2 mbrojtjen e një personi të tillë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit. Në faqen 57-
4 58, të transkriptit të sotëm ju shpjeguat, dëshmuat për një
5 telefonatë që morët nga një dëshmitar, i cili shprehu
6 shqetësimin e tij dhe tha se ju tha dhe po citoj:

7 "E di shumë mirë se ç'ka ndodhur me dëshmitarët në
8 Kosovë".

9 Si e kuptuat ju këtë? Ç'donte të thoshte dëshmitari me
10 këtë sipas jush?

11 Pë. Unë kam një farë njohurie, përvoja nga rajoni i
12 Ballkanit, nga puna që kam bërë, për punën që kam bërë për
13 TPNJ-në. Ka pasur shumë incidente që u kanë ndodhur
14 dëshmitarëve dhe nga përvoja ime di se kanë ndodhur disa
15 incidente edhe gjatë kohës së UNMIK-ut dhe EULEX-it, ku disa
16 dëshmitarë janë kërcënuar dhe mendoj që atë kishte parasysh ky
17 person në telefonatën e tij.

18 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në faqen 47-48 të
19 transkriptit dhe ju sapo e përsëritët, thatë që kishte
20 kategori të ndryshme dëshmitarësh lidhur me përgjegjësitë
21 tuaja profesionale. Dhe një prej këtyre kategorive ishin
22 viktima dhe na shpjeguat se ç'do të thotë viktimë. A mund të
23 na shpjegosh se për se kategorinë e viktimave e trajtoni si
24 një nënkategori dëshmitarësh për shkak të nevojave, aspektet
25 që merren parasysh në trajtimin e këtyre personave, përse?

1 Pë. Në rastin e viktimave, mendojmë që ata janë persona më të
2 cenueshëm se viktimat që janë kërcënuar apo që kanë pësuar
3 dëm. Pra nga ana psikologjike mendojmë se janë më të
4 cenueshëm, më të brishtë.

5 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mos do të thotë kjo se në
6 rastin e tyre kërkohen masa të veçanta siç na shpjeguat?

7 Pë. Hapa të veçantë në kuptimin që i këshillojmë të marrin
8 ndihmë psikologjike apo ndonjë ndihmë profesionale për të
9 përmirësuar gjendjen e tyre shëndetësore.

10 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Të supozojmë një skenar të
11 tillë dhe dua të dëgjoj se ç'mendoni ju si profesionist, jo
12 nga pikëpamja ligjore. Të supozojmë se një dëshmitar e bën të
13 njohur faktin se është dëshmitar lidhur me këtë juridiksion.
14 Nëse do të ndodhte një gjë e tillë, një person i tillë do ta
15 humbiste mbrojtjen, të cilën ndryshe do ta merrte nga ju dhe
16 nga zyra juaj?

17 Pë. Jo. Nuk është kjo një arsye të humbasë mbrojtjen tonë. Ne
18 e diskutojmë një gjë të tillë me dëshmitarin, u themi se çfarë
19 ndodh dhe e pyesim arsyet përse e ka bërë publik një fakt të
20 tillë.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Gjithashtu dëshmuat më
22 herët se një numër personash të cilët i morët ju apo ju morën
23 ata, shprehën frikë, shqetësim dhe se ju ndërморët disa hapa
24 dhe masa dhe në veçanti në faqen 60-61 të transkriptit vutë në
25 dukje dhe besoj se bëhej fjalë për një person që u zhvendos

1 dhe për të tjerë për të cilët siç thatë bëtë vlerësim
2 emergjent të rrezikut.

3 Pyetja ime është, masa të tilla ishin masa të zakonshme,
4 ato bëheshin normalisht apo janë të veçanta, të rralla dhe jo
5 shumë të shpeshta relativisht?

6 Pë. Kur flasim për zhvendosjen është vërtetë një masë e
7 veçantë, e quajmë masa e fundit, kur s'kemi masa të tjera. Për
8 të mbrojtur dikë në vendin e tij, në territorin e Kosovës
9 propozojmë zhvendosjen e një personi të tillë.

10 Pra është një masë - edhe plani i menaxhimit të riskut,
11 plani emergjent është gjithashtu jo i zakonshëm. Bëhet për ata
12 dëshmitarë që janë më të pambrojtur, më të cenueshëm, që
13 gjithashtu nga perspektiva jonë janë të rëndësishëm për Zyrën
14 e Prokurorisë.

15 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Pra, po ju pyes në
16 përgjithësi pa u futur në hollësi teknike. Por çfarë niveli
17 kërcënimi për mendimin tuaj do të arsyetonte një masë të tillë
18 të jashtëzakonshme, pra çfarë?

19 Pë. Nivel i lartë kërcënimi.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
22 Barthe ka një pyetje.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Kryetar.

24 Mirëdita z. Jukiç.

25 Pë. Mirëdita.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kam dhe unë disa pyetje për
2 ju. E para, nëse nuk gabohem, na thatë sot se ju dhe kolegët
3 keni kontaktuar rreth 200 dëshmitarë mbas konferencave për
4 median në OVL UÇK në shtator 2020, kështu është?

5 Pë. Po, afërsisht 200 mijë, 200 më fal.

6 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa prej këtyre personave
7 shprehën shqetësim për sigurinë? Mbase nuk mund të jepni një
8 shifër të saktë, po një vlerësim të përafërt.

9 Pë. E kam vështirë të them, po shumica e tyre shprehën një
10 farë shqetësimi, një shumicë e madhe.

11 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Kur thoni shumicë, më shumë
12 se njëqind do të thonit?

13 Pë. Po, më shumë se njëqind.

14 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa prej këtyre personave u
15 thanë se ishin kërcënuar në shtator apo mbas shtatorit të
16 2020-s?

17 Pë. Nuk e mbaj mend.

18 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Afërsisht?

19 Pë. Shumë pak kishin marrë kërcënim të drejtpërdrejtë. Jo
20 shumë.

21 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më pak se njëqind?

22 Pë. Po, më pak se njëqind.

23 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Po nuk mund të jepni një
24 shifër më të saktë?

25 Pë. Jo, në këtë çast.

1 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Sa prej këtyre personave
2 keni kontaktuar ju apo kolegët, që kontaktuat ju apo kolegët u
3 zhvendosën? Mbj mend që përmendët një person, i cili u
4 zhvendos. Ishte ky i vetmi person që u zhvendos?
5 Pë. Jo, kishte me shumë se një. Më shumë se një person u
6 zhvendos.

7 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Më shumë se një? Mund të
8 thoni se sa?

9 Pë. Dy.

10 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Dy tamam?

11 Pë. Po.

12 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Për sa dëshmitarë të tjerë u
13 morën masa sigurie apo mbrojtëse?

14 Pë. Rreth 20-30. Nga 20 deri në 30.

15 GJYKATËSI BARTHE: [Përkthim] Faleminderit z. Jukiç.

16 Nuk kam pyetje të tjera.

17 Pë. Jeni të mirëpritur.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

19 Mund ta nxirrni dëshmitarin znj. Sekretare nga salla e gjyqit.

20 Faleminderit z. Jukiç.

21 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Meqë nuk kemi
23 gjëra të tjera e mbarojmë punën për sot.

24 Do të rishihemi të enjten e ardhshme në orën 9.30.

25 --- Seanca mbyllet në orën 15.06